

MARKO ZVRLEVSKI  
TODOR VITLAROV  
JOVAN ILIEVSKI

ZBATIMI PRAKTIK I MARRËVESHJES PËR LLOJIN DHE  
LARTËSINË E SANKSIONIT PENAL NË VITIN E PARË TË  
ZBATIMIT TË LIGJIT TË RI PËR PROCEDURË PENALE

ANALIZA JURIDIKE



Marko Zvrlevski  
Todor Vitlarov  
Jovan Ilievski

**ZBATIMI PRAKTIK I MARRËVESHJES PËR LLOJIN DHE  
LARTËSINË E SANKSIONIT PENAL NË VITIN E PARË TË  
ZBATIMIT TË LIGJIT TË RI PËR PROCEDURË PENALE**

**ANALIZA JURIDIKE**

**Shkup, 2016**

Autorë:

**Marko Zvrlevski,** *Prokuror publik i Republikës së Maqedonisë*  
**d-r Todor Vitlarov,** *Prokuror i lartë publik në Prokurorinë e lartë të Shtipit*  
**d-r Jovan Ilievski,** *Prokuror publik në Prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit*

Redaktor dhe bashkëpunëtor:

**Ana Novakova Zhikova,** *Oficere Kombëtare për Sundimin e së Drejtës pranë Misionit të OSBE në Shkup*

Përthyer nga: Blerina Zllatku

Tirazhi: 200 ekzemplarë

Shtypi: Poliesterdej, Shkup

CIP –Katalogizimi në publikim



Përmbajtja e këtij publikimi nuk i pasqyron çdoherë pikëpamjet dhe qëndrimet e Misionit të OSBE në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së



## **PËRMBAJTJA**

Në vend të hyrjes.....	4
Objekti dhe qëllimi i Analizës.....	4
Korniza metodologjike e përdorur gjatë hartimit të Analizës.....	5

## **I. MARRËVESHJA PËR SANKSIONIN PENAL NË SISTEMIN PENAL VENDOR .....**

1. Përse marrëveshje?.....	5
2. Marrëveshja – institut i ri juridiko-procedural në sistemin juridiko-penal të vendit.....	7
2.1. Aktet nënligjore për zbatimin e institutit të marrëveshjes....	14
3. Marrëveshje për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal përmes shifrave dhe fakteve.....	21
3.1. Marrëveshje të lidhura në juridiksionin e prokurorive të larta publike sipas strukturës së veprave penale.....	23
3.2. Lloji dhe lartësia e sanksioneve penale për të cilat kanë rënë dakord gjatë procedurës së marrëveshjes.....	31
3.3 Pikëpamje përfundimtare dhe rekomandime .....	39
4. Pikëpamje komparative për zbatimin e marrëveshjes në vende të tjera.....	40

## Në vend të hyrjes

Analiza e zbatimit praktik të marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, në përputhje me Ligjin për procedurë penale të vitit 2010 (LPP), paraqet një kontribut të përbashkët të Shoqatës së Prokurorëve Publik dhe Sektorit për Sundimin e së Drejtës pranë Misionit të OSBE në Shkup ndaj procesit të vendosjes së politikës dhe praktikës së unifikuar penale në sistemin tonë juridiko-penal. E njëjta i trajton të dhënat që kanë të bëjnë me marrëveshjet e realizuara në katër juridiksionet e gjykatave të apelit në: Manastir, Gostivar, Shkup dhe Shtip, brenda periudhës nga 1 dhjetori 2013 deri në 31 mars të vitit 2015.

E drejta tradicionale e procedurës penale dhe praktika gjyqësore tipike për nënqiellin evropian, vite me radhë, i kundërviheshin drejtësisë me marrëveshje, përkatësisht drejtësisë konsensuale duke u nisur nga përcaktimi se reagimi penal është rregulluar në mënyrë të rreptë me ligj dhe nuk e njuh dialogun, kompromisin dhe as marrëveshjen, duke e pasur parasysh faktin se qëllimi kryesor është mbrojtja e vlerave fundamentale sociale.<sup>1</sup>

Zgjidhjet e reja, të parashikuara me LPP me të cilat në mënyrë thelbësore reformohet veprimi procedural, në të vërtetë paraqesin institute anglo-saksone të cilat kanë traditë shumëvjeçare në shtetet *common law*, nënkuptohet me përshtatjen e tyre të nevojshme ndaj praktikës evropiane të jurisprudencës.

## Objekti dhe qëllimi i Analizës

Objekt i Analizës është zbatimi i institutit të marrëveshjes nga aspekti i veprimit praktik të prokurorëve publikë. Qëllimii autorëve është që përmes pasqyrës statistikore dhe analitike të të dhënave të përpunuara të mundësohet një panoramë fillestare lidhur me:

- Zbatimin praktik të marrëveshjes për sanksionin penal;
- Unifikimin e veprimit me marrëveshjet në juridiksionin e katër prokurorive të larta publike; dhe
- Politikën penale të lëndëve për të cilat është miratuar aktgjykim në bazë të marrëveshjes së prokurorit publik dhe të pandehurit.

<sup>1</sup> Francoise Tulkens, *Negotiated Justice, European Criminal Procedures*, (ed. Dalmans-Marty/Spencer),

## **Korniza metodologjike e përdorur gjatë hartimit të Analizës**

Duke e pasur parasysh se Analiza fillimisht është fokusuar në drejtim të veprimit praktik të prokurorëve publikë, ekipi i autorëve i cili punoi në këtë hulumtim vjen nga radhët e prokurorëve nga të gjitha shkallët e veprimit. Gjatë hulumtimit u përdorën disa qasje metodologjike në drejtim të sigurimit të të dhënave përkatëse për zbatimin e këtij instituti të ri juridiko-penal:

- Përpunimi statistikor dhe kryqëzimi i të dhënave për numrin e përgjithshëm të personave të cilëve u janë ngritur kallëzime gjatë vitit 2013, 2014 dhe 2015, me numrin e kallëzimeve penale të hedhura poshtë dhe me numrin e personave për të cilët procedura penale ka vazhduar dhe përfunduar me miratimin e aktgjykimit në bazë të propozim-marrëveshjes;
- Analiza e të gjitha marrëveshjes të lidhura midis prokurorit publik dhe të pandehurit në periudhën nga 1 dhjetori i vitit 2013 deri në 31 mars të vitit 2015 në juridiksionin e katër prokurorive të larta publike;
- Përpunimi veç e veç statistikor i të dhënave për marrëveshjes e lidhura në prokuroritë themelore publike, si dhe pasqyra e përgjithshme e të dhënave në nivel të prokurorive të larta publike;
- Analiza dhe përpunimi statistikor i politikës penale dhe llojit të veprave penale për të cilat janë lidhur ujdi në periudhën nga 1 dhjetori i vitit 2013 deri më 31 mars të vitit 2015;
- Konsultimet dhe bisedat me gjyqtarë, avokatë dhe prokurorë të cilët kanë pasur përvojë me marrëveshje për sanksionin penal.

## **I. MARRËVESHJA PËR SANKSIONIN PENAL NË SISTEMIN PENAL VENDOR**

### ***1. Përse marrëveshje?***

Aspektet bashkëkohore të drejtësisë penale kategorizohen me një zhvillim dhe reformim dinamik në më shumë drejtime në mënyrë që drejtësia penale të jetë njëlloj e arritshme për të gjithë qytetarët dhe të realizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Përpjekjet e këtilla rezultojnë me kërkimin konstant të zgjidhjeve të ndryshme që do të shkojnë në drejtim të përshpejtimit të procedurës penale. Veprimi i thjeshtëzuar është parakusht për përshpejtimin e procedurës penale. Përvojat krahasuese flasin se shumica e shteteve, më së shpeshti ia mësyjnë pranimit të instituteve tanimë të konfirmuara nga ana e shteteve tjera, me ç'rast vinë deri në përzierjen e instituteve tradicionale nga tradita juridike anglo-saksone në sistemet juridike me traditë kontinentale evropiane. Trendi i këtillë në tendencat

bashkëkohore të drejtësisë penale, ndërsa me këtë edhe në të drejtën e procedurës penale, është rezultat, para së gjithash, i stërzgjatjes së procedurave penale, kompleksitetit të tyre, si dhe vëllimit të rritur të lëndëve në punën e gjykatave<sup>2</sup>.

Në literaturën procedurale penale, tanimë një kohë të gjatë, hasen akuza për atë se procedura e kombinuar penale karakterizohet me ngadalësi, formalizëm të theksuar, pa fleksibilitet dhe si rezultat i gjithë kësaj joefikase. Ligji për procedurë penale<sup>3</sup> (LPP) nga viti 2010 përmban dispozita të cilat për herë të parë në legjislacionin tonë procedural penal e rregullojnë mundësinë e marrëveshjes midis prokurorit publik dhe të pandehurit për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, parashikojnë një status të ndryshëm të deklaratës për pranimin e fajit në fazën e kontrollit të akuzës dhe pranimin e dhënë gjatë seancës kryesore në procedurë të rregullt, si dhe gjatë seancës së procedurës së shkurtuar për dallim nga praktika e deritanishme sa i përket pranimit të cilin i akuzuari mund ta jepte para gjykatës<sup>4</sup>.

Siç është theksuar në arsyetimin e LPP, përpjekjet që veprimi penal të jetë efikas dhe ekonomik kanë rezultuar me një sërë studime dhe analiza në lidhje me leverdinë ekonomike dhe përparësitë të cilat e karakterizojnë marrëveshjen, e cila vlerësohet si mekanizëm i tregut për përmirësimin e cilësisë së ndjekjes penale me të cilin reduktohen shpenzimet në procedurën penale. Format e marrëveshjes (ose pajtimit) së mundshme të prokurorit publik dhe të akuzuarit ose e ashtuquajtura drejtësi kontraktuale, zgjerimi i kornizave të mundësive e që gjatë veprimit i gëzon prokurori publik për veprat më të lehta penale, respektimi i pozitës së të dëmtuarit, mendimi i tij dhe pëlqimi për heqje dorë nga rrjedha e rregullt e procedurës penale, dëmshpërblimi i realizuar si mundësi që të mos ngritet procedurë penale, përkatësisht zgjidhje të kontesteve përmes mediatorit, përcaktimi i afateve të shkurtra dhe efikase për ndërmarrjen e veprimeve konkrete procedurale, si dhe pranimi i formave të veçanta të procedurave të përsheptuara, në masë të konsiderueshme duhet të kontribuojnë në drejtim të tejkalimit të problemeve kryesore sa i përket stërzgjatjes dhe kompleksitetit të procedurës penale, si dhe ta rrisin efikasitetin e gjykatave përmes zgjidhjes së shpejtë të prurjeve gjithnjë në rritje të lëndëve penale.

<sup>2</sup> Hulumtim komparativ i zgjidhjeve për përsheptimin dhe thjeshtëzimin e procedurës penale, Nanev/Misovski/Buzharovska, Revyja maqedonase e të drejtës penale dhe kriminologjisë nr.1/2008

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare nr.150/2010 dhe 100/2012

<sup>4</sup> Buzharovska, G., Ujdi për fajin: Manual për praktikentë (Gordana Buzharovska, Majkël G. Karnavas, Dejvid Re), Shkup, Misioni i OSBE në Shkup, 2010



Inkorporimi i marrëveshjes si institut i ri juridiko-penal në procedurën penale vendore, gjejnë mbështetje edhe në rekomandimet e BE dhe Këshillit të Evropës, të cilat kanë të bëjnë me përshpejtimin e procedurës penale dhe me thjeshtëzimin e drejtësisë penale, si dhe me gjetjen e formave tjera për zgjidhjen e lëndëve penale<sup>5</sup>.

## **2. Marrëveshja – institut i ri juridiko-procedural në sistemin juridiko-penal të vendit**

Duke e pranuar pohimin se drejtësia efikase penale, në një pjesë, mund të sigurohet edhe përmes procedurave të cilat e mundësojnë dekriminalizimin, mos penalizimin, format alternative të ndjekjes penale dhe thjeshtësimin e procedurës penale, nevojitet të bëhet dallimi midis marrëveshjes si marrëdhënie midis kryerësit të veprës (në cilësinë e të pandehurit ose të akuzuarit dhe detyrimisht mbrojtësit të tij) dhe prokurorit publik, si paditës i autorizuar, si alternativë e procedurës penale, nga negocimi për shkak të dëmshpërblimit, e që mund të zhvillohet ndërmjet kryerësit dhe të dëmtuarit, ndërkaq të cilin e udhëheq personi i tretë i paprekur (mediatori) dhe e ka karakterin e alternativës për ndjekje.

Marrëveshja, në procedurën tonë penale në pajtim me LPP nga viti 2010, paraqet një institut tërësisht të ri gjatë procedurës, i cili është i përafërt me marrëveshjen që zbatohet në shtetet tjera, megjithatë nuk është plotësisht i njëjtë. Me këtë institut, palët-prokurori publik dhe i pandehuri, përkatësisht i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, merren vesh për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal për dallim nga sistemet e tjerë në të cilët mund të bëjnë marrëveshje edhe për kualifikimin juridik të thelbit të veprimeve të ndërmarra penale, si dhe për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal.

Edhe pse marrëveshja në sistemin tonë penal ka të bëjë me llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, megjithatë nga më shumë dispozita të LPP dhe KP mund të nxjerrim si përfundim se në të vërtetë parakusht për marrëveshjen është që i pandehuri të pranojë fajin.

Ekzistojnë dallime sa u përket mundësive për dhënien e deklaratës për pranimin e fajit, përkatësisht për dhënien e pranimit në shkallë të ndryshme të veprimit pas përfundimit të procedurës hetuese. Deklarata për pranimin e fajit është parakusht për lidhjen e marrëveshjes midis palëve në fazën e vlerësimit të akuzës, por jo edhe në procedurën hetuese<sup>6</sup>. Në procedurën hetuese në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e neneve 483 – 490 të LPP, të cilat

<sup>5</sup> Rekomandimi nr. P(87)18 i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës nga viti 1987, për thjeshtëzimin e drejtësisë penale, e cila përmban propozime konkrete për format e procedurave të përshpejtuara dhe të thjeshtëzuara, Rekomandimi nr.P(95)12 i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës nga viti 1995 për administrimin e jurispruencës penale.

<sup>6</sup> Buzharovska, G., Ujdi për fajin: Manual për praktikantët (GordanaBuzharovska, Majkël G. Karnavas, Dejvid Re), Shkup, Misioni i OSBE në Shkup, 2010

nuk kërkojnë pranim paraprak të detyrueshëm të fajit nga ana e të pandehurit. Megjithatë, krahas faktit që në mënyrë eksplicite nuk jepet pranimi i fajit në fazën e procedurës hetuese, vet fillimi i procedurës së marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, në njëfarë mënyre, e supozon këtë.

Një "jokonsekuencë" plotësuese në lidhje me pranimin e fajit është edhe dispozita e paragrafit 1, pikës 1 të nenit 40 të Kodit Penal për zbutjen e dënimit, e cila parashikon se gjykata mund ta zbusë dënimin *"kur shqipton dënim sipas propozim marrëveshjes së paraqitur për pranimin e fajit të lidhur ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit"*.

Nga dispozitat e LPP pa dyshim rezulton se subjektet e negocimit për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal janë prokurori publik nga njëra anë dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nga ana tjetër. Sido që të jetë, subjektet e negocimit janë palë, ndërkaq nëse i pandehuri, përkatësisht i akuzuari ka mbrojtës (të zgjedhur apo të caktuar) në negociatat për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal merr pjesë edhe mbrojtësi i të pandehurit. Në rastin kur i pandehuri, përkatësisht i akuzuari ka mbrojtës, vet procesi i negocimit për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, sipas rregullit, duhet të zhvillohet midis mbrojtësit dhe prokurorit, megjithatë mbrojtësi për rrjedhën dhe përmbajtjen e negocimit e ka për detyrë ta njoftojë të pandehurin. Në procedurën e negocimit për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, e cila zhvillohet midis palëve, në këtë fazë gjykata nuk merr pjesë.

I pandehuri, para fillimit të seancës së parë dëgjimore, do të informohet edhe për të drejtën e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal me prokurorin publik, në përputhje me nenet 489 deri 496 të Ligjit për procedurë penale<sup>7</sup>.

Negocimi për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal mund të iniciohet nga cilado palë qoftë.

Njëri nga kushtet për pranimin e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal është ekzistimi i provave të mjaftueshme për fajin e të akuzuarit, kështu që gjatë fillimit të negociatave supozohet bindja e prokurorit publik për atë se ka në dispozicion prova të mjaftueshme për fajin e të pandehurit. Negocimi ka të bëjë me llojin dhe lartësinë e sanksioneve juridike-penale, përkatësisht sanksionet të cilat do t'i shqiptohen të pandehurit për veprën me të cilën ai ngarkohet.

Atë që prokurori publik mund t'ia ofrojë të pandehurit për pranimin e fajit të tij, për veprën për të cilën ngarkohet, është shqiptimi i sanksionit më të butë i cili nuk e përjashton mundësinë e shqiptimit të dënimit nën minimumin e parashikuar ligjor. Gjatë procesit së marrëveshjes prokurori doemos duhet të lëvizë në kuadër të

<sup>7</sup> Neni 206 paragrafi 6 i Ligjit për procedurë penale, Gazeta Zyrtare nr.150/2010 dhe 100/2012

normave të detyrueshme të Kodit Penal për llojin<sup>8</sup> dhe qëllimin<sup>9</sup> e sanksionit penal, kushtet e shqiptimit të tyre, dënimet të cilat mund të shqiptohen për vepra të caktuara penale dhe për kufijtë e zbutjes së dënimeve të përcaktuara me ligj<sup>10</sup>. Gjatë negociimit prokurori nuk mund të ofrojë shqiptim të dënimit për të pandehurin i cili do të ishte nën dënimin më të ulët e që për një vepër të caktuar penale mund të shqiptohet në përputhje me dispozitat për dënime më të buta nga Kodi Penal, e as që mundet të propozojë shqiptim të dënimit me kusht për vepër për të cilën kjo masë e Kodit Penal nuk mund të shqiptohet. Këto janë kornizat të cilat duhet t'i respektojë edhe mbrojtësi, përkatësisht i pandehuri në procedurën e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal.

Qëllimi i fundit i negociimit është lidhja e marrëveshjes, aktpajtimi në formë të shkruar të cilin e përpilon prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Prezenca e mbrojtësit gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale në lidhje me këtë institut procedural është e obligueshme, përkatësisht i pandehuri doemos duhet të ketë mbrojtës. Pjesëmarrja e gjykatës në fazën e negociimit është përjashtuar plotësisht. Aktivitetet procedurale të gjykatës fillojnë pasi të lidhet propozim-marrëveshjes në formë ligjore dhe pas paraqitjes në shqyrtim.

Objekt i marrëveshjes është lloji dhe lartësia e sanksionit juridiko-penal, ndërsa nëse ka pëlqim nga i pandehuri, objekt i marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësore-juridike nga i dëmtuari. Gjatë marrëveshjes mund të merren vesh edhe për shqiptimin e dënimit nën minimumin ligjor përmes zbatimit të dispozitës për zbutjen e dënimit, për shembull, shqiptim të dënimit me para në vend të dënimit me burgim ose një lloj më i butë i sanksionit juridiko-penal, për shembull, dënim me kusht në vend të dënimit me burgim ose dënim me para. Sanksionet juridike-penale palët duhet t'i përcaktojnë në mënyrë precize, për shembull, gjashtë muaj burgim ose dënim me para me një shumë saktësisht të përcaktuar në denarë. Nëse gjatë negociimit merren në konsideratë kornizat penale të praktikës së vendosur gjyqësore, atëherë reduktohet rreziku për mospranimin e marrëveshjes nga ana e gjykatës. Prokurori mund të ofrojë dënim nën minimumin ligjor përmes zbatimit të dispozitave të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit<sup>11</sup> për zbutjen e dënimit ose variantin më të përshtatshëm, shqiptim të llojit më të butë të sanksionit juridiko-penal.

Në Kapitullin e katërt të këtij Ligji janë parashikuar dy rastetë përcaktimit të sanksionit në procedurën e negociimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit në

<sup>8</sup> Neni 33 i Kodit penal

<sup>9</sup> Neni 32 i Kodit penal

<sup>10</sup> Neni 41 i Kodit penal

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare nr.199/2014

kuadër të marrëveshjes<sup>12</sup>. Gjatë negociimit të prokurorit publik dhe të akuzuarit, gjatë procedurës hetuese dhe në procedurën e shkurtuar deri në paraqitjen e propozim akuzës, nuk mund të bien dakord për dënim më të vogël se 50% nga dënimi që do të shqiptohej me zbatimin e dispozitave të këtij Ligji në procedurë të rregullt gjyqësore. Gjatë negociimit të prokurorit publik dhe të akuzuarit në fazën e vlerësimit të aktakuzës, nuk mund të bien dakord për dënim më të ulët se 60% nga dënimi që do të shqiptohej me zbatimin e dispozitave të këtij Ligji në procedurë të rregullt gjyqësore. Së këtejmi, gjatë veprimit të këtillë, prokurori publik, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij duhet ta kalojnë procesin e përcaktimit të dënimit që do ta bëjë gjykata gjatë seancës kryesore, e që nënkupton edhe plotësim të fletëve të punës, të cilat janë pjesë përbërëse të Ligjit, në mënyrë që të mundën me një probabilitet më të madh ta parashikojnë sanksionin, i cili i është shqiptuar të akuzuarit në seancën kryesore dhe në mënyrë përkatëse ta shfrytëzojnë mundësinë që ua ofron Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit për zvogëlimin e dënimit gjatë negociimit.

Objekt i marrëveshjes mund të jenë edhe masat e sigurisë të cilat paraqesin një nga sanksionet juridike-penale të përcaktuara me Ligjin material penal. Gjithsesi se palët dhe mbrojtësi gjatë përpilimit të ujdisë duhet t'i respektojnë dispozitat juridike-materiale, përkatësisht të lëvizin në kornizat e Kodit Penal dhe Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit. Siç theksuam paraprakisht, nuk mund të dakordohen për dënim ose për sanksion tjetër juridiko-penal i cili nuk është parashikuar me Kodin Penal ose i cili nuk mund të shqiptohet me zbatimin e dispozitave ligjore për zbutjen e dënimit. Propozim-marrëveshja e këtillë duhet të shpallet si e paligjshme, në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë dhe në kundërshtim me interesin publik. Nëse objekt i marrëveshjes është e tërë akuza, vetëm atëherë shmanget procedura e rregullt penale e cila kalon në të gjitha fazat e procedurës penale.

Propozim-marrëveshja duhet t'i përmbajë elementet si vijojnë:

- të dhëna për pjesëmarrësit e procedurës: prokurori publik, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij;
- përshkrimi dhe kualifikimi ligjor i veprave penale. Nëse procedura zhvillohet për më shumë vepra penale, atëherë marrëveshja nuk është e domosdoshme t'u referohet të gjithave, por mund të lidhet edhe për një pjesë të veprave penale;
- sanksioni i propozuar penal sipas llojit dhe lartësisë. Këtu bën pjesë dënimi kryesor, dënimi sekondar, masat e sigurisë, masat alternative dhe masa të tjera të parashikuara me Kodin Penal;

<sup>12</sup> Neni 20 i Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit Gazeta Zyrtare nr.199/2014

- lloji dhe lartësia e kërkesës pronësore-juridike dhe mënyra e realizimit të së njëjtës. Kjo vetëm atëherë nëse i pandehuri bie dakord e njëjta të jetë objekt i marrëveshjes;
- deklarata e të pandehurit se në mënyrë të vetëdijshme dhe vullnetare e pranon propozim-marrëveshjen, si dhe pasojat që burojnë nga e njëjta;
- deklarata e prokurorit publik dhe e të pandehurit se heqin dorë nga e drejta e ankesës nëse miratohet aktgjykim me të cilin pranohet propozim-marrëveshja;
- shpenzimet e procedurës;
- nënshkrimi i prokurorit publik, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, dhe
- data dhe vendi i lidhjes së propozim-marrëveshjes.

Duke i analizuar të dhënat dhe aktet me të cilat prokurori publik, në përputhje me nenin 483 të LPP, e paraqet propozim-marrëveshjes deri te gjyqtari për procedurë paraprake, ekziston praktikë e ndryshme. Me fjalë të tjera, një pjesë e prokurorive e paraqesin vetëm propozim-marrëveshjes (me elementet e nevojshme të parashikuara në nenin 485 të LPP) të nënshkruar nga prokurori publik dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Prokuroritë e tjera publike paraqesin të dhëna me të cilat propozim-marrëveshja është mbyllur, përshkrimin e veprimeve të kundërligjshme, kualifikimin ligjor dhe në vazhdim e japin arsyetimin pa e bashkëngjitur listën e provave. Prokuroritë publike të treta, paraqesin të dhëna me kë është lidhur propozim-marrëveshja, përshkrimin e veprimeve të kundërligjshme, kualifikimin ligjor dhe arsyetimin, ndërsa e bashkëngjisin edhe listën e provave.

Për shkak të unifikimit të praktikës është me rëndësi të theksohet si vijon:

- prokurori publik e paraqet propozim-marrëveshjen (të përpiluar me përmbajtje të parashikuar në nenin 485 të LPP) të nënshkruar nga ana e tij nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Nga kjo dispozitë ligjore nuk rezulton obligim për paraqitjen e arsyetimit.
- Propozim-marrëveshjen prokurori publik e ka për detyrë (neni 483 paragrafi 2 të LPP), bashkë me të gjitha provat (pra, ka obligim të paraqes listën e provave, bashkë me provat) t'ia bashkëngjisë edhe deklaratën me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari në lidhje me llojin dhe lartësinë e kërkesës pronësore-juridike vetëm nëse e njëjta ka qenë objekt i marrëveshjes, në përputhje me nenin 484 të LPP. Në të kundërtën një deklaratë e këtillë nga i dëmtuari nuk ka nevojë të paraqitet.

Pas pranimit të propozim-marrëveshjes, gjyqtari i procedurës paraprake, në afat prej tre ditësh, cakton seancë për vlerësimin e propozim-marrëveshjes në të cilën i thërret palët dhe e ka për detyrë ta shqyrtojë nëse e njëjta është paraqitur vullnetarisht, nëse i dyshuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike nga pranimi i saj, për pasojat lidhur me kërkesën pronësore-juridike dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Prokurori publik, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës nuk kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për përcaktimin e sanksionit penal, të ndryshëm nga sanksioni penal të cilin e përmban propozim-marrëveshja. Nëse paraqesin kërkesë të këtillë atëherë konsiderohet se kanë hequr dorë nga propozim-marrëveshja, ndërsa gjyqtari i procedurës paraprake do të miratojë aktvendim me të cilin do ta refuzojë të njëjtën. Palët kanë të drejtë deri në miratimin e vendimit të heqin dorë nga propozim-marrëveshja, ndërkaq pranimi i propozim-marrëveshjes konsiderohet si heqje dorë nga e drejta e ankesës ndaj aktgjykimit të miratuar në bazë të propozim-marrëveshjes.

Nëse gjyqtari i procedurës paraprake konstaton se provat e siguruarat për faktet erëndësishme për zgjedhjen dhe matjen e sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal, përkatësisht se prokurori publik, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës kanë parashtruar kërkesë për përcaktimin e sanksionit, penal të ndryshëm nga sanksioni penal të cilin e përmban propozim-marrëveshja, miraton aktvendim me të cilin e refuzon propozim-marrëveshjen ndërsa dokumentet/shkresat ia dërgon prokurorit publik.

Nëse gjyqtari i procedurës paraprake e pranon propozim-marrëveshjen, shqipton aktgjykim me të cilin nuk guxon të shqiptojë sanksion penal, të ndryshëm nga sanksioni penal të cilin e përmban propozim-marrëveshja. Aktgjykimi i përmban elementet e aktgjykimit dënues, edhe atë:

- për cilën veprë penale i akuzuari shpallet fajtor, me specifikimin e fakteve dhe rrethanave të cilat janë karakteristikë të veprës penale, si dhe të atyre prej të cilave varet zbatimi i ndonjë dispozite të caktuar të Kodit Penal;
- emërtimi ligjor i veprës penale dhe cilat dispozita të Kodit Penal janë zbatuar;
- me çfarë dënimi dënohet i akuzuari;
- vendim për masat e sigurisë, konfiskim të pronës dhe dobisë pasurore dhe sekuestrim të sendeve;
- vendim për kalkulimin e privimit nga liria, paraburgimit ose të dënimit tanimë të vuajtur; dhe
- vendim për shpenzimet e procedurës penale.

Nëse i akuzuari është i dënuar me dënim me para, në aktgjykimin do të përcaktohet afati brenda të cilit duhet të paguhet dënimi me para, si dhe mënyra e zëvendësimit të dënimit me para në rastin kur dënimi me para nuk mund të arkëtohet madje as në mënyrë të detyrueshme.

Aktgjykimi publikohet menjëherë, ndërsa përpilohet në formë të shkruar brenda tri ditësh nga publikimi dhe pa shtyrje i dërgohet prokurorit publik, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, si dhe të dëmtuarit i cili kërkesën e tij pronësore-juridike mund ta realizojë në procedurë kontestimore.

Në këtë pjesë është me rëndësi të theksohen disa pyetje të cilat parashtrihen në lidhje me marrëveshjen:

» *Si do të veprohet nëse ekzistojnë më shumë të akuzuar, ndërkaq të gjithë nuk arrijnë marrëveshje?*

Mund të themi se gjatë marrëveshjes, nëse ka më shumë bashkë-kryerës, ndërsa me prokurorin publik lidh marrëveshje vetëm njëri ose një pjesë e tyre, gjatë procedurës e cila ka vazhduar për bashkë-kryerësit e tjerë, i pandehuri i cili ka lidhur marrëveshje mund të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit, ndërsa aktgjykimi i cili është miratuar në bazë të lidhjes së marrëveshjes nuk nxirret si provë. Situata e këtillë është shumë e ngjashme me situatat të cilat paraqiten në kohën e zbatimit të Ligjit paraprak për procedurë penale, kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm në pjesën për një të akuzuar, ndërsa është shfuqizuar për bashkë-kryerësit e tjerë, dhe në këtë rast në gjykimin e përsëritur bashkë-kryerësi, për të cilin aktgjykimi është i plotfuqishëm, mund të pyetet si dëshmitar.

» *Si do të veprohet nëse ka më shumë të akuzuar të cilët dëshirojnë të kenë marrëveshje?*

Në këtë rast propozim-marrëveshja kryhet me çdo të akuzuar veç e veç.

» *Në fillim të seancës kryesore, para fillimit të procedurës së provës, i akuzuari a mund ta pranojë fajin dhe këtë marrëveshje për sanksionin penal për një paragraf të caktuar të veprës penale për të cilën është akuzuar ose duhet ta pranojë fajin për të gjithë paragrafët në mënyrë kumulative për të cilët është akuzuar nga vepra e njëjtë penale?*

Në këtë fazë nuk ka mundësi ligjore i akuzuari të lidhë ujdin për sanksionin penal. Deri në përfundimin e fazës së konfirmimit të akuzës i akuzuari mund të bëjë ujdin për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal. Pas konfirmimit të akuzës, i akuzuari mundet vetëm ta pranojë fajin. Nga aspekti procedural kjo nënkupton se gjykata do ta kapërcejë procedurën e provës dhe do t'i qaset matjes së dënimit. Gjykata, mund t'i masë sanksion më të lehtë të akuzuarit.



Në të vërtetë i akuzuari duhet ta pranojë përshkrimin e veprës penale të shpjeguar si në akuzë dhe jo kualifikimin e saktë ligjor të veprës. Nëse ndodhë që i akuzuari të kërkojë të pranojë vetëm një pjesë të elementeve të veprës penale, pavarësisht nëse bëhet fjalë për elementin kryesor ose kualifikator, qasja e këtillë nuk konsiderohet si pranimit i fajit, ndërsa gjykata duhet ta vazhdojë rrjedhën e procedurës penale.

## **2.1 Aktet nënligjore për zbatimin e institutit të marrëveshjes**

Me miratimin e LPP dhe me inkorporimin e institutit të marrëveshjes, përkatësisht pajtim për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në të njëjtin nuk është inkorporuar obligimi i detyrueshëm ligjor për miratimin e akteve nënligjore me të cilat do të lehtësohej zbatimi i këtij instituti. Megjithatë, me hyrjen në fuqi dhe me fillimin e zbatimit të LPP u paraqit nevoja për rishikimin e tij, përkatësisht për unifikimin e mënyrës së veprimit të prokurorëve publikë edhe atë si në aspekt të zbatimit të dispozitave të Ligjit ashtu edhe në aspektin e procedurës në prokurorinë publike e cila nuk është rregulluar plotësisht nga aspekti normativ.

Neni 6 i Ligjit për prokurorinë publike<sup>13</sup> i cili e vë në dukje parimin themelor të hierarkisë dhe subordinimit sipas të cilit është organizuar prokuroria publike, nenin 25 nga Ligji i njëjtë i cili në paragrafin 1 parashikon se: "*(1) Prokurori Publik shtetëror "(...) ka të drejtë t'i jep udhëzime të detyrueshme të përgjithshme me shkrim prokurorit të lartë publik, prokurorit themelor publik për krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe prokurorit themelor publik (...)"*", si dhe në paragrafin 3 të nenit të njëjtë i cili e vë në dukje se udhëzimet kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të caktuara, mes tjerash, edhe për zbulimin dhe ndjekjen më efikase të veprave penale dhe të kryerësve të tyre dhe zbatimin e ligjeve, paraqesin bazë ligjore për miratimin e udhëzimit të detyrueshëm me të cilin rregullohet edhe unifikimi i veprimit/procedimit të prokurorëve publikë në lidhje me institutin miratim të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes së prokurorit publik dhe të pandehurit. Udhëzimi si akt nënligjor është miratuar më 8 nëntor të vitit 2013 dhe u sugjeron prokurorëve publikë, sipas iniciativës vetjake ose kur ekziston propozim nga i akuzuari ose nga mbrojtësi i tij, të marrin pjesë në procedurën e negociimit dhe marrëveshjes në të gjitha rastet në të cilat do të vlerësojnë se me propozim-marrëveshjen më shpejtë dhe në mënyrë më efikase do të realizohet qëllimi i zhvillimit të procedurës penale, ndërkaq veçanërishtkur do të plotësohet një ose më shumë nga kushtet si vijojnë:

- i akuzuari do të jep deklaratë për pranimin e fajit për të gjitha ose për një pjesë të veprave penale nga akuza;

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare nr. 150/2007 dhe 111/2008



- me pranimin e fajit do të mundësohet zbulimi i veprave të tjera penale ose i kryerësve të veprave penale, të cilat janë objekt të marrëveshjes, përkatësisht më lehtë do të dëshmojnë veprat e tjera penale dhe faji i kryerësve të tjerë;
- të dëmtuarit dhe viktimat do të kursehen, përkatësisht do të mbrohen nga implikimet negative gjatë prezantimit publik të deklaratave të tyre gojore në seancë;
- në rastet kur ekziston pëlqimi i të akuzuarit për pranimin e kërkesës pronësore-juridike;
- do të reduktohen shpenzimet e procedurës penale, ndërsa i akuzuari pranon që shpenzimet e krijuara t'i kompensojë.

Në LPP nuk janë parashikuar kufizime në lidhje me atë se për cilën vepër penale mund të fillojë marrëveshja. Sipas rregullit, marrëveshja është e mundshme për çdo vepër penale. Megjithatë, duke e pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për fillimin e zbatimit të një instituti krejtësisht të ri juridiko procedural, u vlerësua se fillimisht nevojitet një qasje më e kujdesshme ndaj marrëveshjes kur bëhet fjalë për lloje të caktuara të veprave penale. Duke u nisur nga kjo me Udhëzimin rekomandohet që prokurorët publikë në parim të mos pranojnë procedura për negociim dhe marrëveshjes në rastet kur bëhet fjalë:

- për krime veçanërisht të rënda në të cilat viktimat janë shumë të traumatizuara, përkatësisht të privuara nga jeta, ndërsa ngjarja juridike-penale ka shkaktuar shqetësim dhe rrezikim të publikut;
- për formë të rëndë të krimit të kryer financiar – vepra penale të abuzimit, korrupsionit dhe vepra tjera të ngjashme me këto, posaçërisht të kryera nga persona zyrtarë në funksione udhëheqëse me të cilat është përfituar dobi e konsiderueshme pronësore, përkatësisht në masë të konsiderueshme është dëmtuar bashkësia shoqërore;
- raste në të cilat prokurori publik ka në dispozicion prova me të cilat dëshmimi është shumë i thjeshtë dhe pritët seanca kryesore të përfundojë shpejtë, ndërsa i akuzuari në negociimet kërkon ulje të konsiderueshme të sanksionit të përcaktuar penal;
- veprat penale janë kryer ndaj fëmijëve, përkatësisht të miturve.

Me Udhëzimin prokurorët publikë detyrimisht duhet që procedurën e negociimit dhe marrëveshjes ta zhvillojnë në hapësirat zyrtare të Prokurorisë Publike, ndërsa në situata të jashtëzakonshme edhe në burgun e hetuesisë dhe ngjashëm. Para se të fillojë procedura e negociimit dhe marrëveshjes, prokurori publik i cili vepron ndaj lëndës konkrete penale detyrimisht duhet ta njoftojë prokurorin publik të Prokurorisë Themelore Publike për fillimin e procedurës së negociimit dhe marrëveshjes, përkatësisht për propozimin e parashtruar nga i akuzuari ose nga mbrojtësi i tij.

Për fillimin dhe rrjedhën e negociemeve, prokurori publik përpilon shënim zyrtar në të cilin arsyetohen shkaqet e negociimit dhe pikat për të cilat është negociuar (veçanërisht duhet të theksohet oferta e prokurorit publik dhe oferta e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij).

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me para apo dënim me burgim deri në 3 vjet, prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike në mënyrë autonome i zhvillon negociatat dhe e nënshkruan propozim-marrëveshjen të lidhur me të akuzuarin.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim deri në 5 vjet, negociatat i zhvillon prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike, ndërsa marrëveshjen e nënshkruan prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim deri në 10 vjet, ujdinë e nënshkruan prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike sipas pëlqimit paraprakisht të siguruar nga Prokurori i Lartë Publik.

Për veprat penale në kompetencë të PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim prej më së paku 4 vjet, përkatësisht më së paku 8 vjet burgim ose mund të shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, ujdinë e nënshkruan prokurori publik i PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, përkatësisht i Prokurorisë Themelore Publike sipas pëlqimit paraprakisht të siguruar nga Prokurori Publik.

Nëse procedura e negociimit nuk ka sukses, pavarësisht shkaqeve, (mospranim të kushteve të ofruara në procedurën e negociimit nga ana e prokurorit publik, përkatësisht nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij dhe ngjashëm), prokurori publik i cili ka marrë pjesë në procedurën e negociimit për të njëjtën do të përpilojë shënim zyrtar dhe do ta njoftojë prokurorin publik të Prokurorisë Themelore Publike, prokurorin publik të PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe prokurorët e tjerë sipas hierarkisë në rastet e pikës 7<sup>14</sup> dhe pikës 8<sup>15</sup> të këtij Udhëzimi.

Udhëzimi i detyrueshëm zbatohet nga 1 dhjetori i vitit 2013, përkatësisht nga dita e fillimit të zbatimit të LPP.

<sup>14</sup> Pika 7 nga Udhëzimi i detyrueshëm thotë: "Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burgim deri në 10 vjet, marrëveshjen e nënshkruan prokurori publik i prokurorisë themelore sipas miratimit të marrë më përpara nga ana e prokurorit të lartë publik".

<sup>15</sup> Pika 8 nga Udhëzimi i detyrueshëm thotë: "Për veprat penale të cilat janë nën kompetencat të prokurorisë themelore publike për krim të organizuar dhe korrupsionit dhe për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burg më së paku 4 vjet, më saktësisht dënim me burgim për më së paku prej 8 viteve ose mund të shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, marrëveshjen e nënshkruajnë Prokurori Publik i Prokurorisë themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, më saktësisht nga Prokuroria themelore sipas miratimit të marrë më përpara nga ana e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë".

Me numrin e rritur të procedurave për marrëveshje, si dhe me praktikën të vënë deri më tani, më 25 Nëntor 2015, Prokurori publik solli një Udhëzim të rë të detyrueshëm. Përparimi më i madh me Udhëzimin e ri ju dha mundësia prokurorëve publikë që të mundën të lidhin propozim marrëveshje për të gjitha veprat penale, duke përfshirë edhe veprat për të cilat me udhëzimin e parë kishte kufizime. Procesi i negociimit dhe marrëveshjes mes prokurorit publik me të dyshuarit (pandehurit) me Udhëzimin e ri u rregullua si në mënyrën në vazhdim:

- për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me të holla ose dënim me burgim deri më 5 vjet, prokurori publik i prokurorisë themelore në mënyrë të pavarur i zhvillon negociatat dhe nënshkruan propozim marrëveshjen të lidhur me të pandehurin
- për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burg deri më 10 vjet i zhvillon prokurori publik i prokurorisë themelore dhe gjithashtu nënshkruan marrëveshjen sipas miratimit me shkrim të marrë më përpara nga ana e prokurorit themelor të prokurorisë themelore publike.
- Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burgim mbi 10 vjet me përjashtim të veprave penale të pikës<sup>16</sup> 8 të këtij Udhëzimi, marrëveshjen e nënshkruan prokurori publik i nënprokurorisë themelore publike sipas miratimit me shkrim nga prokurori publik i prokurorisë së lartë publike
- Për veprat penale të cilat janë nën kompetencën e PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit për të cilat është paraparë dënim me burg mbi 10 vjet për veprat penale të kryerjes së krimit financiar (veprat penale të keqpërdorimit, korrupsionit) të kryera nga ana e zyrtarëve të zgjedhur ose të emëruar (persona zyrtarë në poste udhëheqëse) dhe për vepra penale për të cilat ekziston interes i veçantë publik, ndërsa janë nën kompetencat e prokurorisë themelore publike ose the PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për veprat penale për të cilat mundet të shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, marrëveshjen e nënshkruan prokurori publik në PTHP sipas miratimit me shkrim të marrë më përpara nga ana e Prokurorit publik shtetëror.

<sup>16</sup> Pika 8 nga Udhëzimi i ri i obligueshëm nga data 25,11,2015 thotë: "për veprat penale të cilat janë nën kompetencën e Prokurorisë themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit për të cilat vepra është paraparë dënim me burg më tepër se 10 vjet;

- për veprat penale të kryerjes së krimit financiar (veprat penale të keqpërdorimit, korrupsionit) të kryera nga ana e zyrtarëve të zgjedhur ose të emëruar (zyrtarë në poste udhëheqëse) dhe për vepra penale për të cilat ekziston interes i veçantë publik, e janë nën kompetencat e prokurorisë themelore ose të prokurorisë themelore publike për krim të organizuar dhe korrupsion; dhe

- për vepra penale për të cilat mund të shqiptohet burgim i përjetshëm, marrëveshjen e nënshkruajnë prokurori publik në prokurorisë themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, më saktësisht në prokurorisë themelore publike pas miratimit të marrë më parë me shkrim nga ana e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë."

Edhe pse këta udhëzime të detyrueshme e arritën qëllimin e tyre në drejtimin e harmonizimit të veprimeve të prokurorëve publikë në lidhje me institucionin e sjelljes të aktvendimit në bazë të marrëveshjes të prokurorit publik dhe të dyshuarit, për prokurorët publikë do të ishte tepër e dobishme sjellja e udhëzimeve të tjera shtesë me qëllim të precizimit të të gjithë procesit për fillimin dhe rrjedhjen e procedurës e cila do të mbaronte me lidhjen e propozim marrëveshjes mes prokurorit publik dhe të dyshuarit. Këta udhëzime të përgjithshme duhet të përmbanin disa udhëzime shtesë në kuptimin e asaj që vijon:

- para se ta marr vendimin për fillimin e negociemeve, prokurori publik do t'i shqyrtojë provat, të gjitha rrethanat dhe pasojat nga marrëveshja; veçanërisht do të jetë i kujdesshëm nëse në rastin konkret lidhja e marrëveshjes për sanksionin penal është në përputhje me ligjin, përkatësisht a janë plotësuar kushtet e Udhëzimit të detyrueshëm për negociim dhe marrëveshje me të akuzuarin;
- nëse propozimi për procedurën e negociimit dhe marrëveshjes parashtrohet nga i akuzuari, përkatësisht nga mbrojtësi i tij, ndërsa prokurori publik vlerëson se nuk ka vend për marrëveshje në rastin konkret, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ose në rastin kur nuk ka marrë pëlqim nga prokurorët eprorë, kur pëlqimi i këtillë është i nevojshëm, atëherë do ta njoftojë me shkrim të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij;
- nëse prokurori publik vlerëson se mund ta fillojë procedurën e negociimit për marrëveshje, pa marrë parasysh nëse iniciativa parashtrohet nga ai ose nga i akuzuari apo mbrojtësi i tij, do të përpilojë shënim zyrtar në të cilin do t'i arsyetojë shkaqet e negociimit, si dhe llojin dhe lartësinë e sanksionit penal të propozuar nga i akuzuari, përkatësisht mbrojtësi i tij, përkatësisht sanksionin penal të cilin prokurori publik vlerëson të shqiptohet, përkatësisht për të cilin do të nënshkruaj propozim-marrëveshjen;
- prokurori publik do tua dërgojë shënimin zyrtar prokurorëve eprorë për pëlqim, në përputhje me Udhëzimin e detyrueshëm;
- në lëndët penale në të cilat është përcaktuar masa paraburgim dhe në raste të tjera urgjente, pëlqimi mund të kërkohet edhe me njoftim përmes telefonit nga prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike, për çka do të përpilohet shënim zyrtar i cili do të jetë pjesë përbërëse e kërkesës për pëlqim;
- kur prokurori publik do ta pranojë pëlqimin e nevojshëm me shkrim ose me telefon, do ta njoftojë të akuzuarin, përkatësisht mbrojtësin e tij se është dakord të fillojë procedura për negociim dhe marrëveshje;

- për rrjedhën e procedurës së marrëveshjes dhe për propozimet e parashtruara nga i akuzuari, përkatësisht nga mbrojtësi i tij, do të përpilohet shënim i shkurtër zyrtar ose procesverbal të cilin duhet ta nënshkruajnë prokurori publik, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij;
- nëse i akuzuari nuk ka mbrojtës, ndërsa nuk është në gjendje financiare që të siguroj mbrojtës, prokurori publik do të kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake të caktoj mbrojtës sipas detyrës zyrtare për të akuzuarin i cili në këtë procedurë do t'i përfaqësoj interesat e tij;
- sanksioni penal për të cilin kanë rënë dakord prokurori publik dhe i akuzuari, nuk duhet të jetë nën kornizat e përcaktuara ligjore për veprën penale konkrete, por jo edhe nën kufijtë e zbutjes së dënimit<sup>17</sup>;
- në përputhje me nenin 53 të LPP, prokurori publik duhet ta njoftojë edhe viktimën për qëllimin e fillimit të negociatave në mënyrë që të shmangen reagimet eventuale negative të saj në lidhje me nënshkrimin e propozim-marrëveshjes. Nëse viktima si i dëmtuar, përkatësisht i dëmtuari, nuk paraqesin kërkesë pronësore-juridike atëherë deklaratat e tyre të nënshkruara prokurori publik duhet t'ia dërgojë gjykatës bashkë me propozim-marrëveshjen;
- nëse viktima si e dëmtuar ose i dëmtuari parashtrojnë kërkesë pronësore-juridike, e njëjta mund të jetë objekt i marrëveshjes në lartësinë të cilën e kanë caktuar nëse i akuzuari deklaron pëlqim për kompensimin e pjesëshëm ose të plotë të kërkesës pronësore-juridike;
- kundërshtimi i viktimës ose i të dëmtuarit nuk e pengon prokurorin publik të nënshkruaj propozim-marrëveshje me të akuzuarin;
- me propozim-marrëveshjen nuk mund të ndryshohen pasojat e dispozitave ligjore për sekuestrimin e dobisë së fituar pronësore përmes veprës së kryer penale dhe për sekuestrimin e sendeve. Së këtejmi, propozim-marrëveshja çdoherë duhet ta përmbajë sekuestrimin e dobisë pronësore, përkatësisht sekuestrimin e sendeve;
- gjatë rrjedhës së negocimit dhe marrëveshjes, prokurori publik nuk duhet ta ndryshojë qëndrimin e tij, duhet t'i përmbahet asaj për të cilën kanë rënë dakord, të vendos besim të ndërsjellë me të akuzuarin dhe me mbrojtësin e tij dhe nuk guxon ta keqpërdor besimin nëse pala tjetër i përmbahet asaj për të cilën kanë rënë dakord.

17 Shih Nenin 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e KP, Gazeta Zyrtare nr.28/2014.

Rregullat e procedurës për zbatimin e marrëveshjes janë përcaktuar me Udhëzimin e detyrueshëm dhe të njëjtat në masë të konsiderueshme ndihmojnë në procesin e unifikimit të mënyrës së veprimit të prokurorëve publikë në territorin e gjithë shtetit.

Matja e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, përkatësisht parashtrimi i propozimit dhe pranimit i propozimit nga i akuzuari, përkatësisht mbrojtësi, realizohet sipas vlerësimit relativisht të lirë të çdo prokurori publik i cili vepron ndaj lëndës konkrete penale. Pse vlerësim relativisht i lirë? Meqë KP, pastaj Rregullorja për mënyrën e matjes së dënimeve dhe në fund Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit i vendosin kufijtë bazikë brenda të cilëve mund të lëvizin sanksionet, përkatësisht dënimet.

» ***Në vend të konkluzionit:***

Nuk duhet të tprohet dhe të shkohet në parashikim të plotë paraprak të dënimit, por duhet t'i lihet diskrecion i vogël prokurorit publik, përkatësisht mundësi për të arritur marrëveshje me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, në kuadër të atij diskrecioni.

Pastaj, ndoshta me Udhëzimin e detyrueshëm do të duhej të rregullohet edhe mënyra e veprimit të prokurorit publik, në rastet kur marrëveshja nuk do të ketë sukses, ndërsa gjykata pas seancës së mbajtur do të merr vendim për dënim me të cilin ai nuk është i kënaqur, përkatësisht duhet të jepet udhëzim për veprim në procedurë ankimore sa i përket asaj se cili derogimi propozuar do të ishte i kënaqshëm për prokurorin publik.

Udhëzimet dhe drejtimet e detyrueshme janë mekanizma të cilat i ka në dispozicion Prokurori Publik për unifikimin dhe rishikimin e veprimeve të caktuara. Aktualisht, kjo më shumë ose më pak është arritur në veprimet e përditshme të prokurorëve publikë.

Sidoqoftë, nevojitet një kohë e konsiderueshme nga zbatimi praktik i marrëveshjes dhe të akteve normative që kanë të bëjnë me çështjet që ndërlidhen me dënimin, në mënyrë që të mendohet për rishikimin e mëtutjeshëm të mangësive të caktuara eventuale.

### ***3. Marrëveshje për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal përmes shifrave dhe fakteve***

Në interes të fitimit të panoramës së plotë për zbatimin e marrëveshjes në praktikë, duhet të merren në konsideratë:

- Numri mesatar i kallëzimeve penale të hedhura poshtë për vitin rrjedhës, dhe
- Numri i përgjithshëm i personave të kallëzuar (fizikë dhe juridikë) si kryerës të veprave penale në të gjitha prokuroritë themelore në nivel vjetor.

Atëherë, duke vepruar ndaj kallëzimeve penale, prokurori publik ka kompetencë ligjore gjatë ekzistimit të disa nga bazat ligjore<sup>18</sup> të hedhë poshtë kallëzimin penal. Së këtejmi, numri i personave kundër të cilëve ka vazhduar procedura penale (përkatësisht për të cilat nuk është miratuar aktvendim për hedhjen poshtë të kallëzimit penal) është i ndryshëm në krahasim me numrin e personave të kallëzuar.

Nënkuptohet se kjo Analizë ka të bëjë me lëndët në të cilat kallëzimi penal nuk është hedhur poshtë, procedura penale ka vazhduar dhe përfunduar me miratimin e aktgjykimit në bazë të propozim-marrëveshjes nga ana gjykatës kompetente themelore. Tabela 1 në vijim ofron një pasqyrë të plotë të të dhënave statistikore për numrin e marrëveshjeve të lidhura dhe për kallëzimet penale të hedhura poshtë në 16 muajt e parë nga implementimi i Ligjit të ri për procedurë penale.

	<b>PL Publike Manastir</b>	<b>PL Publike Gostivar</b>	<b>PL Publike Shkup</b>	<b>PL Publike Shtip</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Numri i personave të kallëzuar</b>	8.480	5.218	14.855	8.271	36.824
<b>Persona kundër të cilëve ka vazhduar procedura penale</b>	3.816	2.188	11.885	5.717	23.606
<b>Marrëveshje të lidhura (për persona)</b>	62	3	199	81	345
<b>Përqindja mesatare e kallëzimeve të hedhura poshtë</b>	45%	42%	20%	32%	34.75%

Tabela 1

Duke i analizuar të dhënat për marrëveshjet e lidhura në juridiksionin e katër prokurorive të larta publike në periudhën e lartpërmendur ka vazhduar procedura penale kundër gjithsej 23.606 personave (në fazën e procedurës hetimore ose akuzës së paraqitur). Prej tyre, prokurorët publikë rajonal kanë lidhur propozim-marrëveshje me gjithsej 345 persona ose 1.46% të personave kundër të cilëve është zhvilluar procedurë penale. Të gjitha propozim-marrëveshjet janë aprovuar nga gjykatat kompetente dhe janë miratuar aktgjykime në përputhje me nenin 483 të LPP.

<sup>18</sup> Shih nenin 288, paragrafi 1 të LPP, Gazeta Zyrtare nr.150/2010 dhe 100/2012



Prokuroritë publike në juridiksionin e PLP Shkup kanë numër më të madh të marrëveshjeve të nënshkruara - me 199 persona, ndërsa prokuroritë në juridiksionin e PLP Gostivar kanë numër më të vogël të marrëveshjeve të lidhura me vetëm 3 persona. Prokuroritë e larta publike në Manastir dhe Shtip kanë një proporcion relativisht të përafërt me 62 përkatësisht 81 persona me të cilët kanë lidhur marrëveshje.

Të dhënat për numrin e kallëzimeve penale të hedhura poshtë janë marrë nga Raportet vjetore për punën e prokurorive të larta publike për muajin dhjetor të vitit 2013 dhe 2014. Për vitin 2015, kur kjo Analizë u hartua, si e dhënë orientuese është marrë mesatarja e kallëzimeve penale të hedhura poshtë nga periudha paraprake.

Numri i personave të cilëve kallëzimi penal u është hedhur poshtë ndryshon varësisht nga juridiksioni i prokurorive të larta publike. Kështu që, në vitin 2014<sup>19</sup> prokuroritë themelore publike nga juridiksioni i prokurorive të larta publike në Manastir dhe Gostivar kanë pasur 56,20%, përkatësisht 56,72%. Në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shtip kjo përqindje është 37,42% nga gjithsej personat e kallëzuar, ndërsa në prokuroritë në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup numri i kallëzimeve penale të hedhura poshtë gjatë vitit 2014 është më i vogël, përkatësisht është 19,54%.

Të dhënat orientuese për numrin e personave për të cilët kallëzimet penale janë hedhur poshtë gjatë vitit 2015, gjithashtu janë të ndryshme për prokuroritë themelore në juridiksionin e çdo prokurorie të lartë publike. Përqindje më të madhe të këtyre personave ka në prokuroritë themelore të juridiksionit të Prokurorisë së Lartë Publike në Manastir me rreth 42-45%, pastaj vjen juridiksioni i Prokurorisë së Lartë Publike në Gostivar me rreth 40-42%, pastaj është juridiksioni i Prokurorisë së Lartë Publike në Shtip me rreth 30-32% të personave të kallëzuar dhe në fund, juridiksioni i Prokurorisë së Lartë Publike Shkup me numër më të madh të personave të kallëzuar kundër të cilëve janë hedhur poshtë kallëzimet penale me rreth 19-20% nga numri i përgjithshëm i personave të kallëzuar. Foto 1 e pasqyron përqindjen e marrëveshjeve të lidhura në juridiksionin e katër prokurorive të larta publike.

<sup>19</sup> Numri i madh i kallëzimeve penale të hedhura poshtë në këtë periudhë ka të bëjë me numrin e madh të kallëzimeve të paraqitura nga ana e fondit për sigurim shëndetësor për veprën penale përdorim të dokumenteve me përmbajtje të falsifikuar nga neni 380 të KP. Në ndërkohë, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim shëndetësor Gazeta Zyrtare nr.98/15, u është dhënë amnisti kryerësve të kësaj vepre penale.






Foto 1

### **3.1 Marrëveshje të lidhura në juridiksionin e prokurorive të larta publike sipas strukturës së veprave penale**

#### **» Prokuroria e Lartë Publike Manastir**

Në juridiksionin e PLP Manastir, siç është prezantuar më lartë, në periudhën nga 1 dhjetori 2013 deri në 31 mars të vitit 2015, në prokuroritë rajonale themelore publike, kanë lidhur marrëveshje me gjithsej 62 persona. Prokuroria Themelore Publike Prilep ka më së shumti marrëveshje të lidhura, përkatësisht me 25 persona, ndërsa prokuroria në Resnjë në këtë periudhë nuk ka lidhur asnjë marrëveshje.

Foto 2 në vazhdim e pasqyron gjendjen e prokurorive rajonale, konform numrit të personave me të cilët është lidhur marrëveshje.




Foto 2

Në Tabelën 2 në vijim, janë prezantuar veprat penale sipas neneve të KP për të cilat prokuroritë themelore publike në juridiksionin e PLP Manastir kanë lidhur marrëveshje me persona të pandehur (të akuzuar).

Vepra penale sipas neneve të KP	PTHP Manastir	PTHP Prilep	PTHP Ohër	PTHP Strugë	PTHP Resnjë	Gjithsej
Neni 131		1				1
Neni 157-a			2			2
Neni 215	3	3				6
Neni 235		4				4
Neni 236		9				9
Neni 237				1		1
Neni 239	1					1
Neni 244-a	1			1		2
Neni 247		1				1
Neni 268	1					1
Neni 277		1				1
Neni 278				3		3
Neni 279		1				1
Neni 285	1					1
Neni 286			12			12
Neni 300	1	1		3		5
Neni 358	1					1
Neni 366	1					1
Neni 377		1				1
Neni 378		1		1		2
Neni 382				1		1
Neni 383		2				2
Neni 396	2			1		3

Tabela 2

Të dhënat e analizuara vënë në dukje se prokurorët publikë kanë lidhur **më shumë marrëveshje** për veprën penale të nenit 286 të KP–**Cenimi i të drejtës së shpikjes të paraqitur ose të mbrojtur dhe topografisë së qarqeve integrale** edhe atë me gjithsej 12 të pandehur (të akuzuar). Të gjitha 12 marrëveshje të janë lidhur nga ana e PTHP Ohër. Prokuroritë themelore publike kanë lidhur marrëveshje me 9 persona për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 236 të KP, me 6 persona për veprën penale nga neni 215 të KP–Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve, ndërsa me 4 persona është lidhur marrëveshje për veprën penale Vjedhje nga neni 235 të KP. Për veprat tjera penale, të cilat janë pasqyruar në Tabelën 2, prokuroritë themelore publike kanë lidhur 1 deri në 3 marrëveshje.

### » **Prokuroria e Lartë Publike Gostivar**

Prokuroritë themelore publike rajonale nga ky juridiksion kanë numër më të vogël të marrëveshjeve të lidhura me vetëm 3 persona, edhe atë dy marrëveshje të lidhura në PTHP Tetovë dhe një në PTHP Gostivar.




Foto 3

Siç është prezantuar në Foto 3, prokuroritë themelore në Kërçovë dhe Dibër në periudhën e analizuar nuk e kanë zbatuar institutin marrëveshje.

Sa i përket strukturës së veprave penale, për të cilat janë lidhur të tre marrëveshjet në juridiksionin e kësaj Prokurorie të Lartë Publike, me nga një të pandehur (të akuzuar) është lidhur marrëveshje për këto vepra penale: Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve nga neni 215 tëKP, Vjedhje nga neni 235 të KP dhe Dhunë nga neni 386 tëKP.

### » **Prokuroria e Lartë Publike Shkup**

Prokuroritë themelore publike në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup kanë numër më të madh të marrëveshjeve të lidhura edhe atë gjithsej me 199 persona. Në këtë numër nuk janë përfshirë të dhënat për marrëveshjet e lidhura nga na e PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Të njëjtat janë prezantuar në një nëntitull të veçantë, në vazhdim të tekstit. Foto 4 në vijim e prezanton numrin e marrëveshjeve të lidhura sipas personave në çdo prokurori themelore.




Foto 4

Siç pritej, si prokurori më e madhe në shtet, PTHP Shkup ka numër më të madh të marrëveshjeve të lidhura me gjithsej 83 persona, ndërsa PTHP Kriva Pallankë ka numër më të vogël të marrëveshjeve të lidhura me 3 persona. Struktura e veprave penale për të cilat është lidhur marrëveshje për person janë prezantuar në Tabelën 3.

Vepra penale sipas neneve të KP	PTHP Shkup	PTHP Kumanovë	PTHP Veles	PTHP Gjevgjeli	PTHP Kavadar	PTHP Kriva Pallankë	Gjithsej
Neni 130	1	1					2
Neni 131	8		1				9
Neni 140	2			3			5
Neni 144		1					1
Neni 161		1					1
Neni 215	24	9	4				37
Neni 216	7		2				9
Neni 223		3					3
Neni 228		1					1
Neni 235		2	1				3
Neni 236	4	3					7
Neni 237	4	2					6
Neni 239		1					1
Neni 242	1						1
Neni 244-a			7				7
Neni 247		1					1
Neni 251	1						1
Neni 259				1			1
Neni 261	2						2
Neni 268			2				2
Neni 278		2	1			2	5
Neni 279	2						2
Neni 285	2		16				18
Neni 288		1					1
Neni 292		1					1
Neni 297				1			1
Neni 300	1	1	1		1		4
Neni 353	3	3					6
Neni 353-b			2	2			4
Neni 354			1				1
Neni 357	2						2
Neni 358	2			1			3
Neni 365		2					2
Neni 378	4	4		4			12
Neni 380		1			2		3
Neni 382	1					1	2
Neni 383	1			2	2		5
Neni 386		3					3
Neni 389		1					1
Neni 396	9	2	4				15
Neni 402				4			4
Vepra penale nga Ligji për punë devizore neni 54		2					2
Vepra penale nga Ligji për akcizat neni 60	2						2

Tabela 3

Duke e shqyrtuar strukturën e veprave penale për të cilat prokuroritë themelore kanë bërë marrëveshje, një opus i shumëllojshëm haset në PTHP Shkup, PTHP Kumanovë dhe PTHP Veles. Përkatësisht, numri më i madh i marrëveshjeve të lidhura, me gjithsej 37 persona kanë të bëjnë me veprën penale **Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga** neni 215 të KP. Të tri prokuroritë themelore publike edhe veç e veç kanë numër më të lartë të marrëveshjeve të lidhura për këtë vepër.

Vepra e ardhshme penale për të cilën këto tri prokurori kanë lidhur marrëveshje është Përpunimi i paautorizuar, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregtimi me armë ose me materiale plasëse nga neni 396 të KP, me gjithsej marrëveshje të lidhura kundër 15 personave të pandehur (të akuzuar).

Është interesante se PTHP Shkup ka lidhur 8 marrëveshje për veprën penale nga neni 131 – Lëndim i rëndë trupor dhe përveç PTHP Veles ku ka vetëm një marrëveshje për këtë vepër, asnjë prokurori tjetër themelore nga juridiksioni i Prokurorisë së Lartë Publike Shkup nuk kabërë marrëveshje për këtë vepër.

Të dhënat e prezantuara në tabelën më lartë, flasin se vepra penale Cenimi i të drejtave të pronësisë industriale dhe përdorimi i paautorizuar i firmës së huaj nga neni 285 të KP është e radhës me frekuencë më të madhe gjatë lidhjes së marrëveshjeve në këtë juridiksion, me gjithsej marrëveshje të lidhura me 18 të pandehur (të akuzuar), (me 16 persona në PTHP Veles dhe 2 në PTHP Shkup), si dhe vepra penale nga neni 378 të KP – Falsifikim të dokumentit me marrëveshje të lidhura me 12 persona.

PTHP Kavadar dhe PTHP Kriva Pallankë, duke e pasur parasysh se kanë deri në pesë marrëveshje të lidhura, më së shpeshti kanë bërë marrëveshje për veprën penale nga neni 278 të KP – Kontrabandë, pastaj Përdorim të dokumentit me përmbajtje të falsifikuar nga neni 380 të KP dhe Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë nga neni 383 të KP. PTHP Gjevgjeli është në kufirin e mesëm me gjithsej 18 persona me të cilët ka lidhur marrëveshje për vepra të ndryshme penale, prej të cilave më së shumti (me nga katër persona) për veprat penale Falsifikim të dokumentit nga neni 378 dhe Kalim i palejueshëm të kufirit shtetëror nga neni 402 të KP.

Përveç veprave penale të parashikuara me KP, në praktikën e PTHP Shkup dhe PTHP Kumanovë kemi edhe marrëveshje për vepra penale nga ligje të tjerë, përkatësisht nga Ligji për punë devizore (neni 54)<sup>20</sup> dhe Ligji për akcizat (neni 60)<sup>21</sup>. Në krahasim me prokuroritë

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare nr. 34/2001, 49/2001, 103/2001, 51/2003, 81/2008, 24/2011, 135/2011, 188/2013, 97/2015, 153/2015 dhe 23/2016.

<sup>21</sup> Gazeta Zyrtare nr. 32/2001; 50/2001; 52/2001; 45/2002; 98/2002; 24/2003; 96/2004; 38/2005; 88/2008; 105/2009; 34/2010; 24/2011; 55/2011; 135/2011; 82/2013; 98/2013; 43/2014; 167/2014; 188/2014; 129/2015; 154/2015; 192/2015; 23/2016 dhe 31/2016.

publike në juridiksionin e tri prokurorive tjera të larta publike, vetëm në PTHP Shkup dhe PTHP Kumanovë kanë bërë marrëveshje për vepra të parashikuara me *lexspecialis*.

- *Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit*

Në periudhën nga 1 dhjetori i vitit 2013 deri më 31 mars të vitit 2015 në PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit janë paraqitur 256 kallëzime penale kundër 563 personave. Një pjesë e lëndëve kundër 66 personave janë zgjidhur pa miratimin e vendimit të prokurorisë publike për ndërmarjen e ndjekjes penale (kallëzime penale të hedhura poshtë, ndërprerje të procedurës dhe lëndë të paraqitura për veprim kompetent deri te prokurori të tjera), kështu që në punë kanë ngelur 227 lëndë kundër 497 personave.

Marrëveshja për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal si institut procedural në këto 227 lëndë kundër 497 personave është zbatuar me gjithsej 161 persona me të cilët kjo Prokurori ka lidhur marrëveshje. Nga ana tjetër, kundër 336 personave të tjerë ndjekja penale ka vazhduar deri në miratimin e vendimit të Prokurorisë Publike (Aktakuzë ose Propozim akuzë) meqë nga ana e personave të kallëzuar dhe mbrojtësve të tyre nuk është parashtruar iniciativë për fillimin e procedurës për marrëveshje ose nuk është arritur pëlqim për lidhjen emarrëveshjes.

Sipas të dhënave, paraprakisht të prezantuara, mund të konkludohet se me marrëveshje janë zgjidhur procedurat kundër 32,4% nga numri i përgjithshëm i personave kundër të cilëve është ngritur kallëzim.

Statistika sa i përket strukturës së veprave penale për të cilat PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit ka lidhur marrëveshje për person, është prezantuar në Tabelën 4 në vijim.

<b>Vepra penale sipas neneve të KP</b>	<b>PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit</b>
Neni 215, paragrafi 3	11
Член 394	38
Neni 316, paragrafi 4 n.l. me Nenin 24 dhe Nenin 151, paragrafi 4 n.l. me Nenin 45	1
Neni 353	1
Neni 418-a, paragrafi 1	1
Neni 418-b, paragrafi 1	1
Neni 418-b, paragrafi 2	56
Neni 418-b, paragrafi 4 n.l. me paragrafin 2	37
Neni 418-v, paragrafi 1	1
Neni 418-v, paragrafi 2	4
Neni 418-d, paragrafi 3	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>161</b>

Tabela 4

Duke i analizuar të dhënat për strukturën e veprave penale për të cilat PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit ka lidhur marrëveshje, **numri më i madh**, përkatësisht marrëveshjet me gjithsej 94 persona kanë të bëjnë me veprën penale nga neni 418 - btë KP – **Kontrabandimi i migrantëve**, edhe atë marrëveshje me 56 persona sipas paragrafit 2, 37 marrëveshje sipas paragrafit 4 n.l. me paragrafin 2 dhe 1, marrëveshje sipas paragrafit 1 të këtij neni. Vepër tjetër penale është Organizata kriminale nga neni 394 të KP për të cilën kjo prokurori ka lidhur marrëveshje me 38 persona. Këto dy vepra penale përfshijnë 81,37% të opusit të përgjithshëm të marrëveshjeve të lidhura gjatë 16 muajve të parë nga zbatimi i Ligjit të ri për procedurë penale (LPP).

Marrë në përgjithësi, numri i propozim-marrëveshjeve të lidhura në PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit është proporcional me numrin e personave të kallëzuar për vepër të caktuar penale, kështu që për ato vepra penale për të cilat ka numër më të madh të personave të kallëzuar, ka edhe numër më të madh të propozim-marrëveshjeve të lidhura.

### » **Prokuroria e Lartë Publike Shtip**

Prokuroritë themelore të këtij juridiksioni në periudhën e analizuar kanë lidhur marrëveshje me gjithsej 81 persona. Siç është prezantuar në Foto 5, PTHP Strumicë ka numër më të madh të marrëveshjeve të lidhura me gjithsej 41 persona ose 50,62% nga të gjitha marrëveshjet e lidhura në këtë juridiksion.

Prokuroritë në Radovish, Koçani dhe Dellçevë gjithsej kanë lidhur 45,70%, ndërsa prokuroritë në Shtip, Sveti Nikole dhe Berovë vetëm 3,68% me nga një marrëveshje.




Foto 5

Sa i përket strukturës së veprave penale për të cilat më së shpeshti janë lidhur marrëveshje në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike – Shtip, në vijim prezantohet statistika në Tabelën 5.

Vepra penale sipas neneve të KP	PTHP Strumicë	PTHP Radovish	PTHP Koçani	PTHP Dellçevë	PTHP Shtip	PTHP Sveti Nikole	PTHP Berovë	Gjithsej
Neni 157	8	13						21
Neni 166	1							1
Neni 215	2		2	1	1			6
Neni 235				2				2
Neni 236			1	2				3
Neni 239	2			1				3
Neni 244-a	5		3					8
Neni 251				1				1
Neni 257			1					1
Neni 261			1					1
Neni 274-b	2		1					3
Neni 278	2							2
Neni 278-b		2						2
Neni 279	2			1				3
Neni 285	2							2
Neni 297	1						1	2
Neni 300				1				1
Neni 345	1							1
Neni 353		1						1
Neni 353-v		1						1
Neni 354	1							1
Neni 358	1							1
Neni 378	4	1						5
Neni 379	2							2
Neni 382	1							1
Neni 386	3					1		4
Neni 396	1		1					2

Tabela 5

Të dhënat për llojin e veprave penale për të cilat janë lidhur marrëveshje në periudhën e analizuar tregojnë se në PTHP Strumicë përfshirja e veprave është e shumëllojshme. **Numri më i madhi** personave – 21 me të cilët janë lidhur marrëveshje kanë qenë të akuzuar (të pandehur) për veprën penale **Cenimi i të drejtës autoriale dhe të drejtave të përfaqësuara** nga neni 157 të KP.

Një vepër tjetër për të cilën janë lidhur më së shpeshti marrëveshje – me 8 të akuzuar (të pandehur) është Ndërtimi pa leje nga neni 244-a të KP. Nga numri i përgjithshëm i personave me të cilët janë lidhur marrëveshje, 43,21% e marrëveshjeve kanë të bëjnë me vepra të ndryshme penale për të cilat kanë lidhur marrëveshje prej 1 deri 5 persona.

Duke i kryqëzuar të dhënat nga juridiksionet e të gjitha prokurorive të larta në lidhje me strukturën e veprave penale për të cilat prokuroritë më së shumti kanë bërë marrëveshje, mund të vërehet si vijon:



- Përveç veprës penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 të KP, për të cilën prokuroritë publike kanë lidhur marrëveshje në juridiksionin e të katër prokurorive të larta publike, struktura e veprave penale është e ndryshme në çdo juridiksion. Veprat më të shpeshta penale për të cilat janë lidhur marrëveshje në secilën nga katër prokuroritë e larta është prezantuar në vijim në Tabelën 6.

<b>PLP MANASTIR (vepra penale për të cilat ka më së shumti marrëveshje)</b>	<b>PLP GOSTIVAR (vepra penale për të cilat ka më së shumti marrëveshje)</b>	<b>PLP SHKUP (vepra penale për të cilat ka më së shumti marrëveshje)</b>	<b>PLP SHTIP (vepra penale për të cilat ka më së shumti marrëveshje)</b>
Neni 286 (12 marrëveshje)	<b>Neni 215 (1 marrëveshje)</b>	<b>Neni 215 (37marrëveshje)</b>	Neni 157 (21 marrëveshje)
Neni 236 (9 marrëveshje)	Neni 235 (1 marrëveshje)	Neni 285 (18 marrëveshje)	Neni 244-a (8 marrëveshje)
<b>Neni 215 (6 marrëveshje)</b>	Neni 386 (1 marrëveshje)	Neni396 (15 marrëveshje)	<b>Neni 215 (6 marrëveshje)</b>
Neni 300 (5 marrëveshje)		Neni 378 (12marrëveshje)	Neni 378 (5 marrëveshje)

Tabela 6

- Marrëveshjet e lidhura për këtë lloj të veprave penale çojnë në konkluzionin se në lëndët konkrete prokurori publik ka siguruar më shumë prova relevante juridike me të cilat ngarkohet i pandehuri (i akuzuari) dhe së këtjmi mbrojtja – i akuzuari e kanë pranuar marrëveshjen.

### **3.2. Lloji dhe lartësia e sanksioneve penale për të cilat kanë rënë dakord gjatë procedurës së marrëveshjes**

Në fillim të Analizës vumë në dukje se në periudhën nga 1 dhjetori i vitit 2013 deri në 31 mars të vitit 2015 në territorin e mbarë shtetit janë lidhur marrëveshje me gjithsej 345 persona. Në Tabelën 7 në mënyrë përmbledhëse janë prezantuar sanksionet penale për të cilat kanë bërë marrëveshje të akuzuarit (të pandehurit) në juridiksionin e katër prokurorive të larta publike.

<b>PLP</b>	<b>Masa alternative</b>	<b>Dënim në para</b>	<b>Dënim me burgim</b>						<b>GJITHSEJ PERSONA</b>
			deri 6 m.	nga 6 m. deri 1 vit	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	mbi 5 vjet	
<b>MANASTIR</b>	14	22	16	1	4	3	2		<b>62</b>
<b>GOSTIVAR</b>	2						1		<b>3</b>
<b>SHKUP</b>	132	29	7	2	8	7	7	7	<b>199</b>
<b>SHTIP</b>	42	29	3	3	2	2			<b>81</b>
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>190</b>	<b>80</b>	<b>26</b>	<b>6</b>	<b>14</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>345</b>

Tabela 7

Statistika tregon se **numri më i madh i sanksioneve penale, për të cilat janë lidhur marrëveshje, kanë të bëjnë me masat alternative**, përkatësisht gjithsej 190 të akuzuar (të pandehur) ose **55%** kanë lidhur marrëveshje për ndonjë lloj të masës alternative – më së shpeshti bëhet fjalë për dënimin me kusht. Dënimi me para dhe dënimi me burgim kanë një përfaqësim identik gjatë lidhjes së marrëveshjeve me 23% dhe 22% nga numri i përgjithshëm i personave. Në lidhje me dënimin me burgim, 26 të akuzuar (të pandehur) kanë lidhur marrëveshje për burgim deri në 6 muaj, ndërsa 6 të akuzuar (të pandehur) në kohëzgjatje midis 8 muajve dhe 1 viti. Për dënimin me burgim mbi 5 vjet janë lidhur marrëveshje vetëm në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup.

Duke e analizuar politikën penale në procesin e marrëveshjes rezulton se në numrin më të madh të rasteve të marrëveshjevetë lidhura midis palëve në procedurë penale është arritur marrëveshje për masë alternative si sanksion penal. Kjo shkon në favor të hulumtimeve të deritanishme të politikës penale të gjykatave, sipas së cilës në 50% të aktgjykimeve dënuese është shqiptuar masa alternative<sup>22</sup>.

Në drejtim të analizës më të detajuar të të dhënave, në vijim të tekstit është prezantuar statistika e prokurorive themelore publike nga juridiksioni i çdo prokurorie të lartë publike.

#### » **Prokuroria e Lartë Publike Manastir**

Në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Manastir, prokuroritë themelore rajonale **më së shumti kanë bërë marrëveshje për dënimin me burgim** si sanksion penal, ndërsa **më së paku për masat alternative**. Sa i përket përqindjeve (Foto 6) në këtë juridiksion me 42% të sanksioneve penale për të cilat është bërë marrëveshje të njëjtat kanë të bëjnë me dënimin me burgim. Dënimi me para përfshin 35%, ndërsa masat alternative 23% nga të gjitha sanksionet penale për të cilat kanë bërë marrëveshje të akuzuarit (të pandehurit).




Foto 6

<sup>22</sup> "Raport për punën e prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë për vitin 2014" <http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Izvestaj-na-JORM.pdf>

Tabela 8 në vijim, e prezanton statistikën veç e veç për secilën prokurori publike të këtij juridiksioni.

PTHP	Masa alternative	Dënim me para	Dënim me burgim						GJITHSEJ PERSONA
			deri 6m.	nga 6 m. deri ne 1 vit	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	mbi5 vjet	
MANASTIR	9					2	1		12
PRILEP	2	1	16	1	4	1			25
OHËR		14							14
STRUGË	3	7					1		11
RESNJË									
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>14</b>	<b>22</b>	<b>16</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>		<b>62</b>

Tabela 8

Analizuar veç e veç sipas lartësisë së dënimit me burgim, më së shumti persona – 16 kanë lidhur marrëveshje për dënimin me burgim në lartësi deri në 6 muaj dhe të gjitha janë lidhur me PTHP Prilep, ndërsa në juridiksionin e kësaj prokurorie të lartë publike nuk ka asnjë marrëveshje që ka të bëjë me dënimin me burgim mbi 5 vjet.

Sa i përket llojit të sanksionit penal, pas dënimit me burgim vjen dënimi me të holla me më së shumti marrëveshje të lidhura (me 14 persona) nga ana e PTHP Ohër dhe në fund masat alternative të cilat dominojnë në marrëveshjet e lidhura nga ana e PTHP Manastir (marrëveshje të lidhura me gjithsej 9 persona).

### » *Prokuroria e Lartë Publike Gostivar*

Duke e pasur parasysh faktin se në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Gostivar kemi numër më të vogël të marrëveshjeve të lidhura me vetëm 3 persona, sa i përket llojit dhe lartësisë së sanksionit penal PTHP Tetovë në dy marrëveshjet e lidhura ka rënë dakord për masa alternative, ndërsa PTHP Gostivar ka lidhur një marrëveshje për dënim me burgim në lartësi prej 3 deri në 5 vjet.

PTHP	Masa alternative	Dënim me para	Dënim me burgim						GJITHSEJ PERSONA
			deri 6 m.	nga 6 m. deri ne 1 vit.	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	mbi5 vjet	
TETOVË	2								2
KUMANOVË							1		1
KËRÇOVË									
DIBËR									
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>2</b>						<b>1</b>		<b>3</b>

Tabela 9

## » Prokuroria e Lartë Publike Shkup

Prokuroritë në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup sa i përket llojit të sanksionit penal, **më së shumti kanë bërë marrëveshje për masat alternative** me gjithsej 132 të akuzuar (të pandehur) ose **66%**. **Më pak marrëveshje** janë lidhur **për dënimin me para me 15%** nga numri i përgjithshëm i personave. Tabela 10 dhe Foto 7 në vijim i prezantojnë shifrat dhe përqindjet për llojin dhe lartësinë e sanksioneve penale të lidhura në prokuroritë themelore publike të këtij juridiksioni.

PTHP	Masa alternative	Dënim me para	Dënim me burgim					GJITHSEJ PERSONA	
			deri 6 m.	nga 6 m. deri ne 1 vit.	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet		mbi5 vjet
<b>SHKUP</b>	57	6		1	6	4	7	2	<b>83</b>
<b>KUMANOVË</b>	39	3		1		3		2	<b>48</b>
<b>VELES</b>	28	10			1			3	<b>42</b>
<b>KAVADAR</b>	3	1			1				<b>5</b>
<b>GJEVGJELI</b>	3	8	7						<b>18</b>
<b>KRIVA PALLANKË</b>	2	1							<b>3</b>
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>132</b>	<b>29</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>199</b>

Tabela 10




Foto 7

Duke i analizuar të dhënat, vërehet se PTHP Shkup ka lidhur më së shumti marrëveshje me masa alternative si sanksion edhe atë me 57 persona të akuzuar (të pandehur), ndërsa më së paku ka PTHP Kriva Pallankë duke bërë marrëveshje vetëm me dy persona për këtë sanksion penal. Prokuroritë në Shkup, Kumanovë dhe Veles bashkërisht përbëjnë 93,95% nga numri i përgjithshëm i personave me të cilët është lidhur marrëveshje me masë alternative si sanksion

penal në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup.

Dënimi me burgim si sanksion penal paraqitet në 19% të të gjitha marrëveshjeve të lidhura në këtë juridiksion. Më e pranishme është marrëveshja e lidhur nga PTHP Shkup edhe atë më së shumti në lartësi prej 3-5 vjet dënim me burgim (marrëveshje të lidhura me 7 persona) dhe në lartësi prej 1-2 vjet (marrëveshje të lidhura me 6 persona). Prokuroria në Kriva Pallankë, në periudhën e përfshirë me Analizën, nuk ka lidhur marrëveshje me të cilën parashikohet dënimi me burgim si sanksion penal. Prokuroritë në Shkup, Kumanovë dhe Veles, me përjashtim të PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë të vetme në territorin e mbarë shtetit të cilat kanë lidhur marrëveshje me të cilat parashikohet dënimi me burgim mbi 5 vjet.

Dënimi me para si sanksion penal është i përfaqësuar në 15% të të gjitha marrëveshjeve të lidhura në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup. Prokuroria në Veles ka lidhur marrëveshje me një numër më të madh të personave të akuzuar (të pandehur) – gjithsej 10, në të cilat si sanksion penal parashikohet dënimi me para. Pason PTHP Gjevgjeli me 8 dhe PTHP Shkup me 6 marrëveshje me sanksion të këtillë. Më së paku marrëveshje (me nga 1 person) në të cilat parashikohet dënimi me para si sanksion penal kanë lidhur prokuroritë në Kavadar dhe Kriva Pallankë.

- *Lloji dhe lartësia e sanksioneve penale të përfaqësuara në marrëveshjet e Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit*

Prokuroria për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit nga gjithsej 161 persona me të cilët ka lidhur marrëveshje në **96,20% ka rënë dakord për dënim efektiv me burgim**. Dënimi me kusht është sanksioni tjetër i vetëm krahas dënimit me burgim për të cilin kjo prokurori ka bërë marrëveshje me gjithsej 6 persona të akuzuar (të pandehur) nga numri i përgjithshëm i personave (shih Tabelën 11 në vijim).

Lloji i sanksionit penal për të cilin PTHP KOK ka bërë marrëveshje	Lartësia e sanksionit penal për të cilin PTHP KOK ka bërë marrëveshje	Numri i të akuzuarve të cilët kanë bërë marrëveshje	Gjithsej të akuzuar sipas llojit të sanksionit penal
<b>DËNIM ME KUSHT</b>	Dënim me kusht 1 vit e 4 muaj për 2 vjet	2	<b>6</b>
	Dënim me kusht 1 vit e 6 muaj për 3 vjet	1	
	Dënim me kusht 2 vjet për 5 vjet	2	
	Dënim me kusht 3 vjet për 5 vjet	1	
<b>KDËNIM ME BURGIM</b>	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj	6	<b>155</b>
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 muaj	2	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muaj	3	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 muaj	23	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti	19	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e 2 muaj	2	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e 4 muaj	1	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e 6 muaj	8	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e 7 muaj	3	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e 10 muaj	1	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet	5	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 2 muaj	1	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 3 muaj	3	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 5 muaj	2	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 6 muaj	6	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 7 muaj	1	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 vjet	6	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 vjet e 6 muaj	5	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vjet	15	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vjet e 2 muaj	2	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vjet e 3 muaj	4	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vjet e 5 muaj	1	
	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vjet e 6 muaj	18	
Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 vjet	13		
Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 vjet e 6 muaj	2		
Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 vjet	3		
<b>GJITHSEJ</b>		<b>161</b>	<b>161</b>

Tabela 11

Foto 8 e prezanton proporcionin në përqindje të dënimeve me burgim për të cilat PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit ka bërë marrëveshje në periudhën e analizuar.




Foto 8

Analiza e të dhënave të kësaj prokurorie tregon se më shumë marrëveshje ose 38% kanë të bëjnë me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 deri në 5 vjet. Dënimi tjetër me burgim i përfaqësuar me 30% nga marrëveshjet me numrin e përgjithshëm të të akuzuarve (të pandehurve) është nga 6 muaj deri në 1 vit. Më së paku marrëveshje janë lidhur për dënimin me burgim mbi 5 vjet (vetëm 3% nga numri i përgjithshëm i personave të akuzuar (të pandehur).

Politika e këtyllë penale, në pjesën më të madhe, i referohet llojit të veprave penale, përkatësisht faktit se kjo prokurori vepron ndaj veprave më serioze penale për të cilat janë parashikuar sanksione më të rrepta.

### » **Prokuroria e Lartë Publike Shtip**

Prokuroritë e juridiksionit të Prokurorisë së Lartë Publike Shtip kanë bërë më së shumti marrëveshje për masat alternative përkatësisht me **42 persona të akuzuar (të pandehur)**, ndërsa **më së pakumarrëveshje** kanë lidhur për **dënimin me burgim prej 2-3 vjet (me 2 persona)**. Për dënimin me burgim prej 3 deri në 5 vjet dhe mbi 5 vjet prokuroritë e Prokurorisë së Lartë Publike Shtip nuk kanë lidhur asnjë marrëveshje.

Tabela 12 në vijim ofron një pasqyrë të detajuar të sanksioneve penale për të cilat kanë bërë marrëveshje secila nga prokuroritë e këtij juridiksioni.

PTHP	Masa alternati ve	Dënim me para	Dënim me burgim						GJITHSEJ PERSONA
			deri 6 m.	nga 6m. deri ne 1 vit.	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	mbi5 vjet	
<b>STRUMICË</b>	20	15	2	1	2	1			<b>41</b>
<b>SHTIP</b>						1			<b>1</b>
<b>KOÇANI</b>	8		1	1					<b>10</b>
<b>RADOVISH</b>	7	11							<b>18</b>
<b>DELÇEVË</b>	5	3		1					<b>9</b>
<b>SVETI NIKOLE</b>	1								<b>1</b>
<b>BEROVË</b>	1								<b>1</b>
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>42</b>	<b>29</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>			<b>81</b>

Tabela 12

Të shprehura në përqindje (shih: Foto 9) të dhënat tregojnë se në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Shtip, prokurorët më së shpeshti kanë bërë marrëveshje për masat alternative me gjithsej 52% të të gjitha marrëveshjeve, pastaj për dënimin me para me 36% për qind dhe më së paku për dënimin me burgim i cili është i përfaqësuar me 12% të numrit të përgjithshëm të personave të akuzuar (të pandehur) me të cilët është arritur marrëveshje.




Foto 9

Parimisht, sipas të dhënave statistikore të shqyrtuara në periudhën kohore nga 1 dhjetori i vitit 2013 deri në 31 mars të vitit 2015, prokuroritë themelore publike kanë pasur qasje serioze në implementimin e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal si institut i ri i inkorporuar në të drejtën procedurale.



### 3.3 Pikëpamje përfundimtare dhe rekomandime

- » Prokuroritë publike në juridiksionin e Prokurorisë së Lartë Publike Gostivar do të duhej të tregojnë një aktivitet më të madh në zbatimin e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal;
- » Sipas vëllimit të punës me lëndë aktivitet më të madh rreth implementimit të marrëveshjes do të duhet të ndërmarrin edhe prokuroritë themelore me kompetencë të zgjeruar;
- » Prokuroritë themelore publike me kompetencë themelore të cilat veprojnë ndaj veprave penale për të cilat është përcaktuar dënimi me burgim deri në 5 vjet duhet të tregojnë angazhim më të madh në zbatimin e këtij instituti në fazën e procedurës para-hetimore. Në këtë fazë të procedurës, prokurorët publikë do të duhet të sigurojnë prova relevante ligjore. Në këtë mënyrë të pandehurit, duke u ballafaquar me provat e prezantuara, do të mundën vet të iniciojnë procedurë për marrëveshje me prokurorin publik.
- » Nga këqyrja e propozim-marrëveshjeve të paraqitura me shkrim, në praktikë vërehet përdorimi i formave të ndryshme gjatë përpilimit të propozim-marrëveshjeve. Sa i përket përmbajtjes, propozim-marrëveshjes duhet të përpilohen konform dispozitës ligjore të Nenit 485 të LPP ku është përcaktuar përmbajtja e elementeve të propozim marrëveshjes. Në Aneksin 1 është prezantuar modeli i Propozim-marrëveshjes.
- » Prokurori publik e paraqet propozim-marrëveshjen (të përpiluar me përmbajtjen e Nenit 485 të LPP) të nënshkruar nga ai dhe nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Propozim-marrëveshjes nuk i bashkëngjitet arsyetimi.
- » Prokurori publik e ka për detyrë që propozim-marrëveshjen bashkë me provat t'ia bashkëngjisë edhe listën e provave.
- » Prokurori publik e ka për detyrë që propozim-marrëveshjes t'ia bashkëngjisë edhe deklaratën me shkrim, të nënshkruar nga i dëmtuari sa i përket llojit dhe lartësisë së kërkesës pronësore-juridike vetëm nëse e njëjta ka qenë objekt i marrëveshjes konform Nenit 484 të LPP. Nëse kërkesa pronësore-juridike nuk është objekt i propozim-marrëveshjes, atëherë deklarata e të dëmtuarit nuk ka nevojë të bashkëngjitet.

#### 4. Pikëpamje komparative për zbatimin e marrëveshjes në vende të tjera

Instituti "marrëveshje për pranimin e fajit" sipas konceptit origjiner të miratuar në sistemin juridik penal të **Shteteve të Bashkuara të Amerikës** nënkupton "masë të kombinuar alternative paragjyqësore procedurale-materiale të cilën e përmban "marrëveshja" ndërmjet prokurorit dhe të akuzuarit: prokurori i propozon të akuzuarit ta pranojë fajin dhe të pajtohet për dënimin e caktuar dhe nëse ai e pranon propozimin, atëherë lidhet marrëveshje, e cila e përjashton nevojën për mbajtjen e seancës kryesore dhe për procedurë të mëtutjeshme sipas mjeteve juridike. Marrëveshjen e konfirmon gjykata, e cila e shqipton dënimin pa mbajtur seancë kryesore"<sup>23</sup>.

Marrëveshje për pranimin e fajit (Pleabargaining) përkufizohet<sup>24</sup> si procedurë në të cilën i akuzuari dhe prokurori arrijnë zgjidhje të pranueshme të përbashkët për lëndën penale, të cilën pastaj e miraton gjykata. Ekzistojnë vendime të Gjykatë Supreme në SHBA<sup>25</sup>, me të cilat deklarata me të cilën pranohet faji konsiderohet si e pavlefshme nëse i akuzuari nuk është njoftuar me aktakuzën ose nëse ngarkohet me vepër e cila nuk paraqet vepër penale.

Ky institut procedural zbatimin e vet e gjeti edhe në modelet procedurale në të drejtën kontinentale evropiane. Së këtejmi, **procedura penale italiane** parashikon institut procedural, shqiptim të dënimit me propozim të palëve<sup>26</sup>. Në bazë të pëlqimit të palëve për kualifikimin ligjor të veprës dhe llojit dhe lartësisë së dënimit, miratohet aktgjykim dënues para mbajtjes së seancës kryesore, ndërsa për përmbajtjen e rëndësishme të aktgjykimit dënues doemos duhet jep pëlqim gjykata. Në këtë aspekt, gjykata është e autorizuar ta hedhë poshtë ose ta pranojë propozimin, por mund të shqiptojë edhe dënim tjetër nga dënimi i propozuar në rast të pranimit të propozimit. Propozimi i palëve mund t'i paraqitet gjykatës gjatë hetimit, në seancën preliminare ose në seancën kryesore. Në secilin nga rastet e theksuara aktgjykimi miratohet pa mbajtjen e seancës kryesore, përkatësisht të procedurës së provës. Megjithatë, ky institut procedural është kufizuar disa herë, meqë është kushtëzuar me vepra më të lehta penale dhe me faza të procedurave penale në të cilat palët mund të paraqesin propozim për shqiptimin e dënimit (propozim nuk mund të paraqitet pas fillimit të seancës kryesore në procedurën e shkallës së parë).

Më e rëndësishmja e këtij instituti në Republikën e Italisë është se gjatë matjes së dënimit, në përputhje me dispozitat ligjore, parashikohet zvogëlim i detyrueshëm i dënimit të shqiptuar për një

<sup>23</sup> Cit. Kambovski, 2, 2005, f. 28

<sup>24</sup> Përkufizimi sipas: West's encyclopedia of American Law

<sup>25</sup> Aktgjykimet; Henderson kundër Morgan, 436 U.S. 637 (1976), dhe Bousli kundër SHBA, 523 U.S. 614 (1998)

<sup>26</sup> a.q.patteggiamento

të tretën<sup>27</sup> edhe atë pa kurrfarë kufizimi të llojit të veprave penale sipas lartësisë së dënimit të parashikuar. Ky institut mund të përdoret pa kufizim për të gjitha veprat penale, me atë që për veprat penale për të cilat është parashikuar dënim me vdekje është përcaktuar zvogëlimi i tij në tridhjetë vjet burgim, ndërsa dënimi me burgim me izolim (qeli) ose me shqiptimin e dënimit me vdekje për vepra penale permanente ose për vepra penale të kryera në bashkëveprim, parashikohet zëvendësimi i tij me burgim të përjetshëm<sup>28</sup>.

Në **Republikën e Serbisë** në marrëveshjen për pranimin e fajit, prokurori publik dhe i akuzuari mund të dakordohen për shqiptimin e dënimit i cili sipas rregullit nuk mund të jetë nën minimumin e përcaktuar ligjor të dënimit për veprën penale, me të cilën ngarkohet i akuzuari. Me përjashtim, kur një gjë e këtillë është dukshëm e arsyeshme për shkak të rëndësisë së pranimin të akuzës për zbardhjen e veprës penale me të cilën ngarkohet, ndërkaq dëshmimi i të njëjtës pa pranimin e këtillë do të ishte e pamundur ose mjaft e vështirësuar, përkatësisht për shkak të pengimit, zbulimit ose dëshmimit të veprave tjera penale, si dhe për shkak të ekzistimit të rrethanave të veçanta lehtësuese<sup>29</sup>, prokurori publik dhe i akuzuari mund të bien dakord që të akuzuarit t'i shqiptohet edhe dënim më i butë, në përputhje me dispozitat për zbutjen e dënimit<sup>30</sup>.

I akuzuari në marrëveshjen për pranimin e fajit mund ta pranojë obligimin që në afat të caktuar ta kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, përkatësisht ta kthejë sendin e veprës penale.

**Procedura angleze** nuk e njeh pranimin e fajit por mospranimin e pasojave të dëmshme (*pranimi nolo contendere*)<sup>31</sup>. Me fjalë të tjera, cilat do qofshin vërejtje plotësuese që mund t'i prezantojë prokurori në lidhje me pranimin e tij të fajit automatikisht çojnë në mohimin e pranimin të fajit, ndërkaq në bazë të kësaj gjyqtari cakton seancë kryesore<sup>32</sup>. Sipas kësaj, në sistemin anglez të drejtësisë penale i akuzuari mund të deklarohej vetëm si fajtor ose i pafajshëm sa u përket veprave penale me të cilat ai ngarkohet me aktakuzën.

Nga ana tjetër, sa i përket procedurës për marrëveshje për fajin e të akuzuarit (Plea Bargaining), në përputhje me dispozitat e Ligjit për të drejtën penale, si dhe në përputhje me precedentin e konfirmuar me rastin Turner (1970) 2 QB 321, gjyqtari obligohet të mos ndërhyjë në

<sup>27</sup> Perrodet, f. 369; Maffei, f. 1059; Cirese, Bericci, f. 224 dhe Ma, f. 41

<sup>28</sup> Neni 442 paragrafi 2 të LPP të Italisë

<sup>29</sup> Neni 54 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Serbisë

<sup>30</sup> Neni 57 të Kodit Penal të Republikës së Serbisë

<sup>31</sup> Është interesant pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit i dhënë me shkrim përmes postës. Ky lloj i pranimin është i mundshëm vetëm në rastet të cilat zhvillohen para gjykatave magjistrate, kështu që aktgjykimi mund të miratohet edhe në mungesë të të akuzuarit (Sprack, f. 171-173).

<sup>32</sup> Cit.Sprack, f. 285

procedurën e lidhjes së marrëveshjes për fajin. Në këtë mënyrë, madje edhe nëse të dyja palët në procedurë paraqiten para gjyqtarit, me qëllim që të informohen me qëndrimin e gjyqtarit, gjyqtari nuk guxon t'u jap indikacione për kurrfarë zgjidhje në lidhje me lartësinë e dënimit. Ndalimi i këtillë strikt i gjyqtarit është inkorporuar me ndryshimet e Ligjit për të drejtën penale nga viti 1999 dhe 2005. Në periudhën para miratimit të këtyre ndryshimeve, ka ekzistuar mundësia që palët të shkojnë në kabinetet gjyqësore dhe nga gjyqtarët të kërkojnë përcaktim të propozim-sanksionit mesatar në bazë të provave të paraqitura<sup>33</sup>.

Pastaj, në sistemin anglez të së drejtës penale mund të ekzistoj marrëveshje vetëm në dy baza (që të dyja llojet janë modele të charge bargaining), edhe atë:

- marrëveshje për pranimin e fajit të veprës më të lehtë (përkatësisht rikualifikim i veprës nga vepër e kualifikuar në vepër primare apo nga vepër primare në vepër më të lehtë); dhe
- pranimi i fajit për një vepër penale, ndërsa si rezultat i kësaj prokurori të heq dorë nga ndjekja e veprave të tjera.

Në rastin e dytë, prokurori heq dorë vetëm nga paraqitja e provave në lidhje me pikat tjera të aktakuzës, kështu që ato formalisht qëndrojnë (to lie on the file) në aktakuzën, por për të njëjtat nuk veprohet<sup>34</sup>. Kjo praktikë është shumë e përafërt me modelin amerikan të marrëveshjes rreth fakteve (fact bargaining), me ç'rast prokurori për shkak të marrëveshjes së arritur për pranimin e fajit të të akuzuarit në mënyrë vullnetare para gjykatës nuk nxjerr prova që janë në dëm të të akuzuarit<sup>35</sup>.

Në **Gjermani** procedura e marrëveshjes për lartësinë e dënimit nënkupton ndikim të drejtpërdrejtë ndaj procedurës akuzatore në sistemin gjerman të drejtësisë penale. Marrëveshja joformale për fajin e të akuzuarit në sistemin gjerman të drejtësisë penale është pranimi i fajit nga i akuzuari dhe nxjerrja jo e plotë e provave gjatë seancës kryesore, si rezultat i marrëveshjes midis prokurorit, të akuzuarit dhe gjykatësit të çështjes.

Procedura kryhet gjatë seancës kryesore, ndërsa inicimi i procedurës më së shpeshti bëhet nga ana e prokurorit, ndërkaq konform aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Federale<sup>36</sup>, prokurori dhe i akuzuari detyrimisht duhet t'i zbatojnë rekomandimet si vijojnë:

- nuk mund të ekzistojë marrëveshje sa i përket llojit të veprës penale;
- pranimi i fajit duhet të konfirmohet nga ana e gjykatës në lidhje

<sup>33</sup> Shih Krapac, 2, f. 142

<sup>34</sup> Cit. Krapac, f. 143

<sup>35</sup> Për këtë shih edhe Krstulloviq, f. 72

<sup>36</sup> BGH, Neue Juristische Wocheverfassungsgericht (1987) 2662

me autenticitetin dhe vlefshmërinë;

- të gjitha palët duhet të përfshihen në mënyrë aktive në procedurën e marrëveshjes;
- rezultati i marrëveshjes midis palëve duhet publikisht të vendoset para gjykatës dhe të evidentohet në procesverbal;
- gjykata mund ta përcaktojë vetëm sanksionin më të lartë, por gjykata këtë propozim mund edhe të mos e respektojë, nëse ekzistojnë rrethana të arsyeshme për një të këtillë, me ç'rast për këtë vendim të saj duhet t'i njoftojë palët që janë në procedurë;
- sanksioni çdoherë duhet të korrespondojë me fajin e të akuzuarit, kështu që sanksionet veçanërisht të lehta nuk lejohen; dhe
- i akuzuari nuk guxon të detyrohet ta pranojë marrëveshjen për pranimin e fajit, si rezultat i premtimit për sanksion tepër të ulët ose ti premtohet dënim më i lehtë si rezultat i heqjes dorë nga e drejta e tij e ankimimit<sup>37</sup>.

Praktika gjermane konsiston me negocimin transparent për llojin dhe lartësinë e sanksionit nëse i akuzuari e pranon fajin për veprën e kryer penale gjatë seancës kryesore<sup>38</sup>, me ç'rast marrëveshja shënohet në procesverbal. Pjesëmarrës në procedurën e marrëveshjes janë: i akuzuari, mbrojtësi i tij, prokurori dhe gjyqtari. Në modelin gjerman pjesëmarrja e gjyqtarit në procedurën e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit perceptohet si garanci për matjen e drejtë të sanksionit, vlerësimin adekuat të pranimit të fajit, ndërkaq me këtë edhe respektimin e parimit dhe obligimin e gjyqtarit ta përcaktojë lartësinë materiale. Sa i përket kohës së marrëveshjes në Gjermani kjo ndodh vetëm gjatë seancës kryesore edhe atë më së shpeshti para fillimit të procedurës së provës<sup>39</sup>. Në të vërtetë e drejta e ankimimit është e pakufizuar.

<sup>37</sup> Shih: Bohlander, 501

<sup>38</sup> Herrmann, f. 491

<sup>39</sup> Dubber, f. 490

Në **Francë** marrëveshja për dënimin<sup>40</sup> është institut i ngjashëm me heqjen dorë të kushtëzuar nga ndjekja e prokurorit. Dallimi qëndron aty se në këto raste përfshihet edhe gjykata gjatë vlerësimit dhe konfirmimit të masave të cilat mund t'i shqiptohen të akuzuarit nga ana e prokurorit. Ky institut më së shpeshti përdoret për veprat penale më serioze<sup>41</sup>, por mund të përdoret edhe për vepra penale më të lehta<sup>42</sup>.<sup>43</sup> Për përdorimin e këtij instituti nevojitet përmbushja kumulative e dy kushteve. Kushti i parë është ekzistimi i pranimi të fajit nga ana e të akuzuarit. Kushti i dytë është të jetë kryer vepër për të cilën mund të shqiptohet dënimi me burgim deri në pesë vjet ose dënim me para më së shumti deri në 3750 euro për vepra penale më serioze dhe 750 euro për vepra penale më të lehta. Përveç këtyre kushteve nevojitet edhe pëlqimi i kryerësit për plotësimin vullnetar të obligimeve të imponuara. Karakteristikë e këtij sistemi është se mund të ekzistojë marrëveshje për llojin e obligimeve të cilat prokurori mund t'ia imponojë kryerësit të veprës penale.

---

<sup>40</sup> composition penale

<sup>41</sup> Delites

<sup>42</sup> contraventions

<sup>43</sup> neni. 41-2 dhe 41-3 të LPP - Francë

## Aneksi 1

### Model i Propozim-marrëveshjes

Republika e Maqedonisë  
PROKURORIA THEMEORE PUBLIKE  
KK nr.  
**STRUMICË**

**Deri te:**  
**GJYKATA THEMELORE STRUMICË**  
-Gjyqtari i procedurës paraprake  
**STRUMICË**

Në bazë të Nenit 39 paragrafit 2 alinesë 8 në lidhje me Nenin 483 paragrafi 1 të LPP

Prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike Strumicë dhe i pandehuri nga baba----- dhe nëna ----- i lindur në Strumicë, ndërkaq jeton në-----nr.----- me NUAQ----- me arsim të kryer të mesëm, i punësuar në ----- i martuar, baba i dy fëmijëve, maqedonas, shtetas i RM, deri më tani i padënuar, në prezencë të mbrojtësit të tij ----- avokat nga Strumica, sot më datë ----- në hapësirat e Prokurorisë Themelore Strumicë lidhën:

#### **PROPOZIM – MARRËVESHJE**

Palët e kësaj Propozim - marrëveshjeje ranë dakord për atë se:

I

I pandehuri----- gjatë vitit 2011 dhe 2012 duke punuar si ----- në Strumicë, në mënyrë të paligjshme ka përvetësuar sende të huaja të lëvizshme – para të cilat i janë besuar në lidhje me punën në mënyrë që, mjetet e arkëtuara në para nga pacientët në emër të participimit për shërbime të shfrytëzuara mjekësore për të cilat nuk u ka lëshuar kuitanca ndërsa në ditarin e ambulancës i ka evidentuar me numrat serik të kuitancave me të cilat janë ngarkuar punonjësit e tjerë shëndetësorë, nuk i ka paraqitur në arkën e palës së dëmtuar----- por i ka përvetësuar për vetvete, me çka në vitin 2011 në mënyrë të paligjshme ka përvetësuar për vetvete 41.570,00 denarë dhe në vitin 2012 në mënyrë të paligjshme ka përvetësuar për vetvete 57.800,00 denarë ose gjithsej ka përvetësuar 99.370, 00 denarë, me çka i pandehuri ka kryer veprë penale permanente **SHPËRDORIM** nga neni 239 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe nenin 45 të KP.

II

Palët në këtë Propozim - marrëveshje ranë dakord, të pandehurit----- për veprën penale permanente "**Shpërdorim**" nga neni 239 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe nenin 45 të KP t'i shqiptohet **Masa alternative** –



**Dënim me kusht me të cilin i përcaktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vitesh nuk kryen vepër të re penale.**

III

Palët kanë rënë dakord që i pandehuri ----- në emër të kërkesës pronësore-juridike, palës së dëmtuar----- t'ia paguaj shumën prej 99.370,00 denarë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të Aktgjykimit në bazë të Propozim-marrëveshjesë.

IV

I pandehuri në prezencë të mbrojtësit të tij----- avokat nga Strumica deklaroi se me vetëdije dhe në mënyrë vullnetare e pranon këtë Propozim-marrëveshje, si dhe pasojat të cilat burojnë nga e njëjta.

V

Prokurori publik i PTHP Strumicë----- dhe i pandehuri----- deklaruan se heqin dorë nga e drejta e ankimimit nëse miratohet Aktgjykim me të cilin aprovohet Propozim-marrëveshjea.

VI

Palët e kësaj Propozim-marrëveshjeee ranë dakord që i pandehuri----- t'i kompensojë shpenzimet e krijuara të procedurës penale deri në miratimin e Aktgjykimit në bazë të Propozim-marrëveshjesë në shumë prej 9000,00 (nëntë mijë) denarë në emër të shpërblimit të ekspertizës për ekspertizën e bërë nga personi ekspert ----- me nr. të licencës -----.

Më datë:  
Strumicë

Prokurori publik i PTHP

-----

I pandehuri:

-----

Mbrojtësi:

-----



## Aneksi 2

### Modeli Aktgjykimit të miratuar në bazë të marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të pandehurit

#### NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**GJYKATA THEMELORE STRUMICË** si gjykatë penale e shkallës së parë përmes gjyqtarit të procedurës paraprake ----- me procesverbalistin ----- duke vepruar sipas Propozim-marrëveshjes së prokurorit publik ----- pranë PTHP Strumicë dhe të akuzuarit ----- nga fshati ----- me mbrojtësin ----- avokat nga Strumica, të përpiluar në PTHP Strumicë, KK nr. ----- nga data 31.07.2014, në lidhje me seancën e mbajtur për vlerësimin e Propozim-marrëveshjes në prezencë të prokurorit publik ----- të PTHP Strumicë dhe të akuzuarit ----- me mbrojtësin -----, avokat nga Strumica, më datë 03.09.2014, në përputhje me nenin 397 paragrafi 2 në lidhje me nenin 490 paragrafi 3 nga LPP, e miratoi dhe e shpalli publikisht në prezencë të prokurorit publik -----, të akuzuarit----- dhe mbrojtësit----- avokat nga Strumica, këtë:

#### AKTGJYKIM

Në bazë të Propozim-marrëveshjes

#### I AKUZUARI:

----- nga babai ----- dhe nëna ----- i lindur në vitin ---- në Strumicë, me vendbanim në fsh. ----- nr. K. ----- i martuar, baba i dy fëmijëve, i një fëmije të mitur dhe një fëmije të moshës madhore, me profesion -----, maqedonas, shtetas i R. të Maqedonisë me NUAQ----- me të ardhura mesatare personale prej 16.000,00 denarë, deri më tani i padënuar.

#### ËSHTË FAJTOR

#### SEPSE:

I akuzuari ----- gjatë vitit 2011 dhe 2012 duke punuar si ----- në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar sende të lëvizshme të huaja – para të cilat i janë besuar në lidhje me punën në mënyrë që, mjetet e arkëtuara në para nga pacientët në emër të participimit për shërbime të shfrytëzuara shëndetësore për të cilat nuk ka lëshuar kuitanca, ndërsa në ditarin e ambulancës nuk i ka evidentuar me numra serik të kuitancave me të cilat janë ngarkuar punonjës të tjerë shëndetësorë, nuk i ka paraqitur në arkën e palës së dëmtuar----- por i ka përvetësuar për vetvete, me çka në vitin 2011 në mënyrë të kundërligjshme për vetvete ka përvetësuar 41.570,00 denarë dhe në vitin 2012 në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar për vetvete 57.800,00 denarë ose

gjithsej ka përvetësuar 99.370,00 denarë. Me këto veprime i akuzuari -----  
----- ka kryer vepër penale **"Shpërdorim"** sipas nenit 239 paragrafit 3 në lidhje  
me paragrafin 1 dhe nenit 45 të KP, dhe në përputhje me nenin e cituar, si dhe  
nenin 404 të LPP, në lidhje me nenin 48-a dhe nenin 49 të KP, dhe i:

### SHQIPTOHET

**Masë alternative – Dënim me kusht me të cilin i përcaktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 – një viti, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy vitesh nuk kryen vepër të re penale.**

Në përputhje me nenin 404 paragrafi 1 pika 7 të LPP i akuzuari obligohet që palës së dëmtuar t'i paguajë shumë prej 99.370,00 denarë në emër të dëmit, si dhe t'i paguajë shpenzimet e ekspertizës së kryer në shumë prej 9000,00 denarë personit ekspert----- në xhirollogarinë ----- në Tutunska Banka SHA Shkup në afat prej 15 ditësh nga pranimi i Aktgjykimit.

Në përputhje me nenin 102 paragrafi 2 pika 6 të LPP i akuzuari obligohet të paguajë në mjetet buxhetore të gjykatës paushall në shumë prej 2.000,00 denarë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të Aktgjykimit.

### ARSYETIM

Më datë 04.08.2014 prokurori publik ----- i PTHP Strumicë dhe i akuzuari ----- me mbrojtësin ----- avokat nga Strumica, gjykatësit të procedurës paraprake i paraqitën Propozim-marrëveshje për miratimin e Aktgjykimit në bazë të Propozim-marrëveshjes.

Prokurori publik ia paraqiti gjykatës Propozim-marrëveshjen bashkë me këto prova: deklaratë nga ----- me nr.----- nga data 08.07.2014, konstatim dhe mendim të personit ekspert, ekonomist i diplomuar--- ----- nga data 15.05.2014 dhe ekstrakt nga evidenca penale.

Gjykata bëri këqyrje mbi Propozim-marrëveshjen dhe konstatoi se e njëjta i përmban elementet e parashikuara në nenin 485 të LPP. Me Propozim-marrëveshjen propozohet gjyqtari i procedurës paraprake ta shpall fajtor të akuzuarin----- nga fsh. ----- për veprën penale "Shpërdorim" sipas nenit 239 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe nenit 45 të KP, përshkruar në përmbajtjen e këtij Aktgjykimi dhe t'i shqiptojë Masë alternative – Dënim me kusht me të cilin i përcaktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 – një viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy vitesh nuk kryen vepër të re penale, si dhe ta obligojë që t'ia kompensojë dëmin palës së dëmtuar----- ----- në shumë prej 99.370,00 denarë dhe në emër të shpenzimeve për ekspertizë të kryer t'i paguajë personit ekspert ----- shumë prej 9000,00 denarë.

Gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi se Propozim-marrëveshja, e përmban deklaratën e të akuzuarit se në mënyrë të vetëdijshme dhe vullnetare e pranon Propozim-marrëveshjen dhe pasojat që burojnë nga e njëjta, deklaratën e përbashkët të PK të PTHP dhe të akuzuarit se heqin dorë nga e drejta e ankimit nëse gjykata e aprovon Propozim-marrëveshjen dhe miraton Aktgjykim në bazë të të njëjtës.

Propozim-marrëveshja është përpiluar nga PTHP Strumicë, më datë 31.07.2014 në prezencë të PK ----- të PTHP – Strumicë, të akuzuarit ----- dhe mbrojtësit të tij----- avokat nga Strumica dhe se të njëjtit e kanë nënshkruar dora vet.

Në seancën e zhvilluar për vlerësimin e Propozim-marrëveshjesë, në të cilën parashtruesi i Propozim-marrëveshjes dhe mbrojtësi i të akuzuarit, paraprakisht janë vënë në dijeni në lidhje me nenin 488 të LPP u prononcuan në lidhje me të njëjtën, gjykata konstatoi se Propozim-marrëveshje është paraqitur vullnetarisht, se i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat ligjore nga pranimi i të njëjtës.

Përkatësisht, i akuzuari u prononcua se sa i përket Aktgjykimit të miratuar në bazë të Propozim-marrëveshjes nuk ka të drejtë ankimi.

Pas këqyrjes së gjykatës mbi provat e paraqitura nga prokurori publik, konstatoi se është i arsyeshëm shqiptimi i Masës së propozuar alternative, në mënyrë të drejtë është kalkuluar dëmi dhe shpenzimet rreth ekspertizës, kështu që vendosi ta aprovojë Propozim-marrëveshjen dhe të miratojë Aktgjykim si në dispozitivin.

Në përputhje me nenin 102, paragrafi 2 pika 6 të LPP, i akuzuari u obligua edhe me paushall në shumë prej 2.000.00 denarë në dobi të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga Gjykata Themelore Strumicë nr. ----- nga data -----

Procesverbalist

Gjyqtar i procedurës paraprake

-----

-----

Vihet në dijeni se: Kundër Aktgjykimit nuk lejohet ankesë.

Dërguar deri te:

- PTHP Strumicë
- të akuzuarit
- mbrojtësit





